

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5503
E hënë, 18 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Maqedonia dhe Greqia
nënshkruajnë
marrëveshjen historike
për emrin | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**MILIONERËT
POLITIKË DHE
TË VARFRIT** F. 11



Rexhep QOSJA

**KUR VDES
DËSHMITARI,
VDES EDHE
RRËFIMI PËR
TË, POR JO
EDHE HISTORIA
E TIJ** F. 11



Nga Musa SABEDINI

**VESELI KËRKON NË FRANCË
MBËSHTETJEN E PARISIT
PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE** F. 11

EKONOMI

**ENDE NUK DIHET KOSTOJA
E HEQJES SË ROAMINGUT
NË MES TË KOSOVËS
DHE SHQIPËRISË** F. 9

**SEKTORI FINANCIAR NË
KOSOVË ËSHTË STABIL** F. 8



SPORT

**FFK-ja BËHET ME LOGO TË
RE DHE FANELLA TË REJA** F. 21

**MË 6 KORRIK ZGJEDHET
KRYETARI I FFK-së** F. 21



FLET PËR "EPOKËN E RE", VIGAN QORROLLI | FAQE 4-5

Liberalizimi i vizave mund të ndodhë në vitin 2019

- BE-ja tash e tutje do të interesohet për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi. Liberalizimin e vizave nuk e ka më 'top prioritet'

Juristi dhe ligjëruesi në Universitetin e Prishtinës, Vigan Qorrolli, ka thënë se Kosova ka ende sfida serioze që kanë të bëjnë me korrupsionin, krimin e organizuar, modelin e saj të paqëndrueshëm ekonomik, çështjen e hapur politike të dialogut me Serbinë në Bruksel dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm rajonal. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se dialogut Kosovë - Serbi i duhet një doktrinë e re kombëtare. Qorrolli ka theksuar se dialogu ka shpresë nëse rristrukturohet sepse procesi aktual ka humbur çdo kuptim. Duke folur rreth liberalizimit të vizave, ai ka pohuar se liberalizimi mund të ndodhë brenda muajve të parë të vitit 2019. "Të gjitha parashikimet çojnë nga viti 2019", ka thënë Qorrolli

KA NDËRRUAR JETË BABAI I KRYEMINISTRIT RAMUSH HARADINAJ

Sot i jepet lamtumira e fundit Hilmi Haradinajt

Sot (e hënë) në orën 14:00 në fshatin Glogjan të Komunës së Deçanit me nderime shtetërore e ushtarake do t'i jepet lamtumira e fundit babait të kryeministrit Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinaj, i cili ka ndërruar jetë

në mbrëmjen e së shtunës, pas një sëmundjeje të rëndë. Personaliteti i babait të dy dëshmorëve të kombit dhe katër gjeneralëve të UÇK-së është vlerësuar lart nga shqiptarët e të gjitha trevave | FAQE 3



Ukshin Hoti mbetet ndër figurat madhore të kombit

"Ukshin Hoti mbetet ekzemplar i rrallë dhe ndër figurat madhore të kombit tonë", ka thënë të dielën kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, në tryezën shkencore "Mendimi politik e shkencor i Ukshin Hotit për zgjidhjen e çështjes shqiptare në kontekstin evropian", e cila është organizuar në 75-vjetorin e lindjes së tij | FAQE 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Maqedonia dhe Greqia nënshkruajnë marrëveshjen historike për emrin

Shkupi dhe Athina arritën të dielën marrëveshjen për një emër me përcaktim gjeografik, Maqedonia e Veriut. Me marrëveshje përcaktohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën dhe identitetin. Gjuha maqedonase, siç thuhet në marrëveshje, i takon grupit të gjuhëve sllave dhe se nuk ka asnjë lidhje me kulturën dhe të kaluarën e Maqedonisë antike dhe greke



SHKUP, 17 QERSHOR - Maqedonia dhe Greqia të dielën nënshkruan marrëveshjen për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar të emrit. Dokumenti që parashihet emrin, "Maqedonia e Veriut", u nënshkrua në Prespë, në pjesën e Greqisë, nga ministrat e punëve të jashtme, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Kotzias, në prani të kryeministrit Zoran Zaev dhe Aleksis Tsipras.

Kryeministri grek marrëveshjen e ka vlerësuar shumë të rëndësishme për të ardhmen e dy vendeve. "Kjo është një marrëveshje patriotike mes dy popujve. Me këtë zgjidhet një kontest shumëvjeçar, forcon besimin mes dy vendeve dhe popujve e cila do të hapë edhe një faqe të re në zhvillimin ekonomik mes dy shteteve", ka deklaruar kryeministri Aleksis Tsipras. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, në fjalimin e tij marrëveshjen e ka vlerësuar historike dhe shumë të rëndësishme për të ardhmen evropiane. "Ndjenja ime sot është se me nënshkrimin e marrëveshjes po zhvendosim edhe malet. Sot po i japim fund një kontesti, dallimeve shumëvjeçare që kishin ngritur mure mes dy shteteve. Kemi humbur shumë, por ne pas shumë përpjekjesh arritëm marrëveshje të dinjitetshme për ndërtimin e miqësisë, e kaluara na ka mësuar shumë. Ne po ndërtojmë të ardhmen. Marrëveshje na inkurajon për besim më të madh mes dy vendeve dhe jetë më të mirë mes dy popujve tanë. Po ndërtojmë miqësi me Greqinë. Ajo do të jetë mbështetëse jonë për proceset në vazhdim. Kjo marrëveshje do ta forcojë paqen dhe sigurinë jo vetëm në vendet tona, por edhe më gjerë", ka deklaruar Zaev, duke theksuar se

me këtë marrëveshje qytetarët do të kenë perspektivë më të mirë si dhe do të forcohen miqësia dhe siguria në rajon.

Në aktin e nënshkrimit të marrëveshjes kanë marrë pjesë përfaqësues të lartë ndërkombëtarë si ndërmjetësi i OKB-së, Metju Nimic, shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, komisionari për zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johannes Hahn, Rozmari Di Karko, përgjegjëse për çështje politike e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, si dhe diplomatë nga më shumë vende perëndimore. "Të gjithë duhet të jemi falënderues që kemi liderë të këtyllë, të përgjegjshëm për të ardhmen e vendeve të tyre. Kjo marrëveshje paraqet dokument strategjik për interesat e dy vendeve. Ishte një proces ishte i vështirë, por është kënaqësi kur i gjithë mudi rezultoi me marrëveshje, e cila duhet të jetë shembull për rajonin dhe më gjerë. Me këtë dëshmuam se kur ka vullnet, mund të arrihet marrëveshje", ka deklaruar ndërmjetësi i OKB-së, Metju Nimic.

Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, tha se ndi-

het krenare për marrëveshjen e arritur, e cila, sipas saj, duhet të inkurajojë edhe pjesë të tjera të rajonit për të ndërmarrë hapa të guximshëm për të mirën e paqes dhe prosperiteti në rajon dhe më gjerë. "Kjo marrëveshje e bën Evropën më të bashkuar dhe më paqësore. Kjo nuk është e rëndësishme vetëm për dy palët, por për tërë Evropën. Dy palët na kanë bërë krenarë, ne, evropianët me nënshkrimin e marrëveshjes. Shpresoj se kjo do të jetë një inspirim për shumëkënd në rajon që të marrë hapa të guximshëm, sikur edhe për gjithë Evropën", ka deklaruar Mogherini.

Ndërsa komisionari për zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johannes Hahn, shprehu kënaqësinë që rruga e gjatë e negociatave përfundoi me sukses, me nënshkrimin e marrëveshjes, të cilët e quajti "marrëveshja e së ardhmes". Komisionari Hahn tha se beson se Këshilli Evropian



do të japë përgjigje lidhur me procesin e integritetit të Maqedonisë në BE. "Duhet të ndërmerren hapa të mëtejme që çojnë drejt integritetit evropian. Kjo është një marrëveshje e mirë, një kompromis i mirë, marrëveshje për të cilën çdokush duhet të bëjë lëshime, që të jetë marrëveshje e mirë. Kjo marrëveshje do të kontribuojë për një jetë më të mirë për qytetarët, një të ardhme më të mirë", ka deklaruar komisionari Johannes Hahn.

Marrëveshja që zgjidh kontestin mbi 25-vjeçar, zhblokon procesin e integritetit të Maqedonisë në NATO dhe BE, por edhe normalizon raportet mes dy vendeve, që shpeshherë janë përcjell edhe me tensione dhe bllokada ekonomike.

Emri, Maqedonia e Veriut, në bazë të marrëveshjes, do të përdoret si brenda ashtu edhe jashtë vendit, apo sipas formulës "erga omnes", të cilën në vazhdimësi e ka kërkuar pala greke.

Marrëveshja sqaron edhe çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën maqedonase dhe kombin maqedonas për të cilin sqaron se nuk ka asnjë ligjshmëri me të kaluarën antike të Maqedonisë, si dhe kulturën dhe traditën helene. Sa i përket gjuhës, në marrëveshje thuhet se ajo i takon grupit të gjuhëve sllave.

Dy vendet kishin një marrëveshje në vitin 1995 me të cilën Maqedonia ishte pranuar në Kombet e Bashkuara me referencën ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), por

Athina kishte bllokuar procesin e integritetit në NATO dhe BE me kërkesën për gjetjen e një emri tjetër që nuk do të reflektonte pretendime territoriale ndaj territorit të saj verior me të njëjtin emër, Maqedoni, por që gjithashtu nuk do të kishte lidhshmëri me të kaluarën antike të emrit Maqedoni.

Pas shumë përpjekjesh, në veçanti pas ndërrimit të pushtetit në Maqedoni, ku tani në pushtet janë social-demokratët, Shkupi dhe Athina arritën marrëveshjen për një emër me përcaktim gjeografik, Maqedonia e Veriut. Me marrëveshje përcaktohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën dhe identitetin. Gjuha maqedonase, siç thuhet në marrëveshje, i takon grupit të gjuhëve sllave dhe se nuk asnjë lidhje me kulturën dhe të kaluarën e Maqedonisë antike dhe greke.

Pas nënshkrimit nga dy qeveritë pason faza më e ndërlikuar, ajo e zbatimit të saj, si ratifikimi nga dy parlamentet. Fillimisht ajo duhet të votohet në Kuvendin e Maqedonisë, më pas fillon procedura e ndryshimit të Kushtetutës me qëllim harmonizimin e saj me marrëveshjen e re. Do të ndryshohet preambula që e definon Maqedoninë si shtet të popullit maqedonas, por edhe të gjitha pjesët e tjera që kanë të bëjnë me termet "Maqedoni" dhe "maqedonase". Pas kësaj duhet të mbahet edhe referendum dhe nëse marrëveshja aprovohet nga qytetarët, atëherë e njëjta duhet të ratifikohet edhe nga Parlamenti i Greqisë, i cili duhet ta ratifikojë edhe pranimin e Maqedonisë në NATO si dhe fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e Maqedonisë në BE. Ndryshe, marrëveshja kundërshtohet si nga opozita në Greqi, po ashtu edhe nga ajo në Maqedoni. Dy blloqet opozitare vlerësojnë se marrëveshja rrënon interesat kombëtare maqedonase, përkatësisht greke. Dy opozitat kanë bërë me dije se do t'i përdorin të gjitha mekanizmat për ta penguar zbatimin e marrëveshjes.

Shqipëria përshëndet marrëveshjen për emrin

TIRANË, 17 QERSHOR - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë përshëndet nënshkrimin e

marrëveshjes historike për emrin të arritur mes kryeministrave, Tsipras dhe Zaev. "Nga Prespa piktoreske që bashkon tre popujt dhe

vendet tona fqinje, qytetarët e dy vendeve, të rajonit, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara, u bënë dëshmi-

tarë të një faqeje të re të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit me kah evropian", thuhet në njoftimin e Ministrisë.



Ka ndërruar jetë babai i kryeministrit Ramush Haradinaj

Sot i jepet lamtumira e fundit Hilmi Haradinajt



Sot (e hënë) në orën 14:00 në fshatin Glllogjan të Komunës së Deçanit me nderime shtetërore e ushtarake do t'i jepet lamtumira e fundit babait të kryeministrit Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinaj, i cili ka ndërruar jetë në mbrëmjen e së shtunës pas një sëmundjeje të rëndë. Personaliteti i babait të dy dëshmorëve të kombit dhe katër gjeneralëve të UÇK-së është vlerësuar lart nga shqiptarët e të gjitha trevave. Në ngushëllimet që kanë shprehur për familjen Haradinaj, liderët politikë të shqiptarëve nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria kanë theksuar se baca Hilmi çdoherë do të kujtohet si një burrë i urtë e i matur, i cili i dha shumë Kosovës

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Babai i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, Hilmi Haradinaj, ka ndërruar jetë në mbrëmjen e së shtunës pas një sëmundjeje të rëndë. Lajmin për vdekjen e babait të dy dëshmoreve të kombit e ka konfirmuar vetë kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka treguar edhe kohën dhe vendin e varrimit të babait të tij. "Ju njoftoj se sonte, pas një sëmundjeje të rëndë, ka ndërruar jetë babai ynë, Hilmi Haradinaj. Varrimi i të ndjerit bëhet të hënë, më 18 qershor, në orën 14:00, në Glllogjan. Të ndjerit, dritë i pastë shpirti!", ka shkruar kryeministri në profilin e vet në "Facebook". Me këtë rast familja Haradinaj ka pranuar telegrame ngushëllimi nga liderët politikë të të gjitha trojeve shqiptare.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka vlerësuar se Hilmi Haradinaj ishte burrë i matur

dhe atdhetar i devotshëm. "Me dhimbje të madhe mora lajmin për ndarjen nga jeta të bacës Hilmi. Ishte burrë i urtë, i matur dhe atdhetar i devotshëm, që Kosovës i dha shumë. Baca Hilmi përballoi shumë sfida në jetë. Ngushëllimet më të sinqerta kryeministrit Haradinaj, familjarëve dhe gjithë miqve të tyre. Qoftë i përjetshëm kujtimi për të!", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka deklaruar se me pikëllim të thellë e ka pritur lajmin për vdekjen e bacës Hilmi. "Lajmi për vdekjen e bacës Hilmi më pikëlloi shumë. E njoha në ditët e vështira për Kosovën atëherë kur, së bashku me djemtë e tij e qindra të tjerë nga e gjithë Kosova, po krijonim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Konaku i bacës Hilmi ishte konak i lirisë së Kosovës. Ngushëllime kryeministrit Haradinaj, familjes, miqve dhe të gjithë atyre që patën rastin ta njohin këtë burrë të nderuar të Dukagjinit dhe

mbarë Kosovës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh kryetar i Nismës Socialdemokrate, ka deklaruar se baca Hilmi do të kujtohet gjithmonë si një burrë i urtë, i cili i dha shumë Kosovës. "Me dhimbje të thellë morëm lajmin për vdekjen e babait të heronjve të Kosovës, Luan e Shkëlzen Haradinajt, bacës Hilmi. Në emër të Nismës Socialdemokrate dhe në emrin tim personal i shpreh ngushëllimet më të sinqerta kryeministrit Haradinaj, familjes dhe gjithë miqve të bacës Hilmi. Bacën Hilmi do ta kujtojmë gjithmonë si një burrë të urtë, i cili i dha shumë Kosovës. Lavdi jetës dhe veprës së tij! Pusho i qetë, baca Hilmi!", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Familja Haradinaj është ngushëlluar edhe nga liderët opozitarë. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" se babai i kryeministrit do të përkujtohet përherë me respekt të madh. "Baca Hilmi dhe familja Haradinaj i dhanë lirisë së Kosovës dy prej heronjve më të shquar, Shkëlzen e Luan Haradinaj, dhe luftëtarë të tjerë

të dalluar në luftën çlirimtare. Shteti dhe qytetarët e Kosovës do ta përkujtojnë përherë me nderime dhe respekt Hilmi Haradinajn për patriotizmin, vendosmërinë, urtësinë dhe sakrificën e jashtëzakonshme për lirinë e atdheut", ka shkruar Mustafa.

Ndërsa lideri i Lëvizës Vetëvendosje, Albin Kurti, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", se baca Hilmi ia dha Kosovës katër gjeneralë e dy dëshmorë. "Me pikëllim mësuam për ndarjen nga jeta të bacës Hilmi Haradinaj, babait të dëshmorëve të kombit, Luan e Shkëlzen Haradinaj. Për breza me radhë, trevat shqiptare kanë formësuar dhe kalitur prindër të urtë e të fortë, të cilët qëllim parësor kishin rritjen dhe brumosjen e fëmijëve të tyre në frymën e lirisë dhe atdheadashurisë. Janë brezat e odave, të fjalës e besës, të parmendës e pushkës, të cilët kishin të rrënjësuar thellë dashurinë ndaj tokës e kombit dhe qëndresën në luftën për liri e bashkim. I tillë ishte Hilmi Haradinaj, i cili luftës për çlirimin e Kosovës ia dha katër gjeneralë e dy dëshmorë", ka shkruar Kurti.

Familja Haradinaj ka pranuar ngushëllime edhe nga liderët e shqiptarëve të Maqedonisë dhe

ata të Shqipërisë. Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka treguar se si është njohur me babën e kryeministrit. "U njohëm kur u vra Luani dhe nuk u ndamë kurrë. U njohëm në kohë të vështira, në rrethana të jashtëzakonshme, bashkë njohëm dhimbjen, por edhe krenarinë. Luftove, organizove, frymëzove, qëndrova dhe asnjëherë nuk u ndale. Baca Hilmi, ishe dhe mbete shumë i fortë, po aq i fortë sa edhe djemtë që ia dhe atdheut. Sot të kujton çdo shqiptar kudo që jeton dhe secili prej nesh bashkëndien për këtë humbje. Ndaj dhimbjen me familjarët dhe jam pranë tyre në këto çaste të vështira. Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, Bacë!", ka vlerësuar Ahmeti.

Kurse presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka ngushëlluar familjen Haradinaj për ndarjen nga jeta të bacës Hilmi Haradinaj, duke vlerësuar se ai ishte një burrë i traditës. "Ai ishte një burrë i traditës, mikpritjes dhe atdheadashurisë. Kam pasur fatin e madh ta njoh nga afër dhe ta ndiej mikpritjen bujare të këtij njeriu të madh. Ngushëllime të thella familjes Haradinaj, të afërme dhe miqve të tij të panumërt. Shpirti i tij u prehtë në paqe!", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

AGJENDA E VARRIMIT TË HILMI (NURË) HARADINAJT

- Ceremonia e varrimit do të mbahet sot (e hënë) në orën 14:00 në Glllogjan
- Nga ora 11:00 deri 12:30 homazhe pranë kullës në Glllogjan të Deçanit
- Nga ora 13:00 ceremonia mortore (tubimi i hapur komemorativ - mbrapa kullës së dëshmorëve)
- Në orën 14:00 ceremonia e varrimit do të bëhet me nderime shtetërore e ushtarake

Flet për "Epokën e re", Vigan Qorrolli

Liberalizimi i vizave mund

- BE-ja tash e tutje do të interesohet për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi. Liberalizimin e vizave nuk e ka më 'top prioritet'

Juristi dhe ligjëruesi në Universitetin e Prishtinës, Vigan Qorrolli, ka thënë se Kosova ka ende sfida serioze që kanë të bëjnë me korrupsionin, krimin e organizuar, modelin e saj të paqëndrueshëm ekonomik, çështjen e hapur politike të dialogut me Serbinë në Bruksel dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm rajonal. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se dialogut Kosovë - Serbi i duhet një doktrinë e re kombëtare. Qorrolli ka theksuar se dialogu ka shpresë nëse rristrukturohet sepse procesi aktual ka humbur çdo kuptim. Duke folur rreth liberalizimit të vizave, ai ka pohuar se liberalizimi mund të ndodhë brenda muajve të parë të vitit 2019. "Të gjitha parashikimet çojnë nga viti 2019", ka thënë Qorrolli



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 QERSHOR -

"Epoka e re": Profesor, çfarë vlerësimi keni për qeverisjen e koalicionit PAN dhe për rolin e opozitës?

Qorrolli: Qeverisja në Kosovë nuk bën përjashtim nga një rregull universal i aplikuar gjithandej në demokracitë botërore. Sa më shumë parti në një koalicion qeverisës, aq më e vështirë qeverisja, sepse interesat e partive politike janë aq të mëdha sa që vetëm sistemimi i njerëzve merr disa vjet. Kjo zaten po ndodh, dhe shohim se ende pa u bërë një vit nga formimi i koalicionit PAN sistemimi i njerëzve nëpër pozita publike po vazhdon ende. Duke qenë se sistemi ynë politik është i prishur në themel, çdo reformë e tij bëhet e pamundur në këto rrethana. Edhe nëse ky koalicion ka qëllimet më të mira për t'i sjellë reforma vendit, druaj se kjo mund të ndodhë, sepse së pari duhet ndërruar formën e administrimit të shtetit, tek pastaj njerëzit që marrin poste publike t'i shërbejnë qytetarit të vet. Në një sistem të tillë, pothuajse anarkik, ku secili kryeministër që vjen nuk mund ta ndryshojë mënyrën e qeverisjes së parasë publike dhe rritjes së besimit të qytetarit, bëhet i pamundur zhvillimi i shtetit dhe përfundimi i tranzicionit. Shoqëria kosovare dhe, bashkë me të, edhe elitat politike, ndodhen ende në

tranzicion përderisa të zgjasë kjo agoni, pafundësisht do të kemi qeverisje dhe qeveritarë që funksionojnë me sindromën e 'viti zero', ku gjithsecili krenohet me punën e vet personale, por jo me të arriturat shtetërore dhe me të mirën publike përgjithësisht. Me fjalë të tjera, koalicioni PAN po e zhvillon formën e kultit për vete, duke synuar të lë gjurmë të cilat do të llogariten si historike për ta. Kjo varet nga reformat që do t'i ndërmarrë, pas kalimit në fazën e dytë, sepse e para ishte, siç e thashë, sistemi i njerëzve nëpër pozita publike. A do të ketë kurajë kjo Qeveri dhe kjo mazhorancë të ndërmarrë reforma sistemike, për t'ia bërë një riformatim komplet strukturës shtetërore dhe administrimit të tij, kjo gjë do të varet nga aftësitë e tyre nacional-konservative. Në anën tjetër, edhe opozita nuk bën përjashtim nga rregullat politike të vëna nga ata në kontekstin e Kosovës. Por, ne jemi dëshmitarë se një ditë janë të djathtë, tjetrën të majtë me një fjalë. Qenia e tyre bazohet mbi gjykime krejtësisht taktike me qëllim final arritjen e pushtetit të përkthyer në poste nominale në shtet. Shoqëria jonë është jashtëzakonisht e demoralizuar sepse asnjë organizim partiak në Kosovë nuk i zhvillon lidhjet e vërteta me ta. Ky është parakushti i demokracisë. Prandaj, edhe opozita shpeshherë bazohet në realitete që nuk përkojnë me partitë politike perëndimore

por, me parti oportuniste, që menaxhimin e tyre e bazojnë në ndarje pushteti.

"Epoka e re": Sa ka avancuar agenda evropiane e Kosovës dhe institucionet sa kanë arritur t'i përmbushin obligimet?

Qorrolli: Kritika më e madhe që duhet t'i bëhet elitës sonë politike lidhet pikërisht me liberalizimin e vizave sepse ajo, duke qenë thellësisht e pasinqertë me publikun, ka nxitur pakënaqësinë e njerëzve. Krejt kjo duke i mbajtur qytetarët peng për data

e muaj, ndaj kanë nxitur fluksin e dyndjes së kosovarëve ilegalisht drejt Perëndimit. Komisioni Evropian me gjasë do ta bëjë rekomandimin pozitiv shumë shpejt, por u mbetet dy institucioneve të tjera të BE-së, Këshillit Evropian (organ ku vendosin shefat e shteteve ose qeverive të 28 shteteve anëtare) dhe Parlamentit Evropian ta japin vendimin final për liberalizimin e vizave. Mënyra evropiane e jetesës nënkupton siguri, rend dhe ligj. Qeveria e Kosovës këtë duhet t'ua bëjë të

qartë qytetarëve, të cilët duhet ta dinë se liberalizimi u mundëson më së shumti një qëndrim tre muajsh në vendet e BE-së, me një zbatim strikt të procedurave legale. Proces i është vonuar Kosovës kryesisht për dy faktorë: i pari që lidhet me mosrealizimin e kushteve të Kosovës për çështje krejt teknike, që nga regjistrat civilë, deri te sigurimi i kufijve me shtetet fqinje. Arsyeja e dytë është gjeopolitike, meqë Evropa e ka rritur produktivitetin e humbur me refugjatë jo vetëm nga Ballkani, por prej vitit 2013

të ndodhë në vitin 2019



politike të dialogimit me Serbinë në Bruksel dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm rajonal që e karakterizon, siç janë problemet tregtare me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Trendi, ndonëse është i ngadalshëm, i jep perspektivë Kosovës në një fushë, që Friedrich Nietzsche do ta quante 'kërkesë për pastërti morale'. BE-ja këtë e konsideron domosdoshmëri, prandaj kërkon bashkëpunim të ndershëm me Kosovën për ta bërë të aftë ekonomikisht drejt integritit. Realpolitika evropiane kundrejt Kosovës, jo vetëm në procesin e integritimit evropian, por edhe në reformat e brendshme, duhet të orientohet në kultivimin e shtetësisë sonë me ekonomi të drejtë, sundim të ligjit dhe demokraci të besueshme, jo si kjo brutale që e kemi ne. Përndryshe, në 10-15 vjetët e ardhshëm do të jemi dëshmitarë që reformat e gjithëmbarshme në Kosovë do të jenë të dhimbshme, të mundimshme dhe të rënda.

"Epoka e re": *Këto ditë do të merret vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën. Cilat janë pritjet e juaja në këtë drejtim? Nëse vendimi është pozitiv, kur mund të udhëtojmë pa viza?*

Qorrolli: Me gjithë vonesat dhe rropatjet që po ua bënë padrejtësisht kosovarëve, BE-ja do t'i liberalizojë vizat jo më herët se në pranverën e vitit 2019. Të gjitha parashikimet çojnë kah viti 2019, meqenëse tani po hyjmë në sezonin e pushimeve verore dhe BE-ja do të orientohet tani e tutje nga normalizimi i raporteve Kosovë-Serbi dhe liberalizimin e vizave nuk e ka 'top-prioritet'. Pas marrëveshjes Greqi-Maqedoni për ndryshimin e emrit kushtetues të Maqedonisë, kërkesë do të jetë arritja e marrëveshjes ligjrisht detyruese në mes të Kosovës dhe Serbisë brenda këtij viti, ndërsa liberalizimi i vizave do të mund të ndodhë brenda muajve të parë të vitit 2019. Ky është një parashikim. Çdo optimizëm tjetër që vizat do të hiqen më shpejt, do të jetë utopi.

"Epoka e re": *Si e komentoni vazhdimin e mandatit të EULEX-it edhe për dy vjet në Kosovë?*

Qorrolli: EULEX-i i ka bërë saktësisht të njëjtat gabime si UNMIK-u më parë. Stabiliteti politik i ka kushtuar shumë, sepse është kujdesur për gjëra të thjeshta për Kosovën dhe jo për luftën, ta zëmë, kundër krimit dhe korrupsionit apo edhe për trajtimin e krimeve të luftës, të

cilat raste, zaten, prokurorët dhe gjyqtarët vendës nuk kanë pasur kompetenca deri në vitin 2014. Një mision ndërkombëtar për sundimin e ligjit çdoherë merr në konsideratë dy faktorë. I pari lidhet me narracionin politik. Një tendencë e përhershme për t'i ruajtur hilet politike në vend, kryesisht për qëllime të stabilitetit. Këtë e ka bërë EULEX-i, i udhëhequr nga teknokratë evropianë, herë gjeneralë ushtrish, herë politikanë me përvojë, të cilët në Bruksel kanë raportuar për gjendjen politike, por jo idetë progresive që çojnë në fuqizimin e drejtësisë. I dyti, që lidhet me aspektin e drejtësisë, është udhëheqja hibride e këtyre institucioneve. Deri vonë, kemi pasur, si në kohën e UNMIK-ut, bashkudhëheqës në dogana, burgje, apo edhe në panelet mikste prokuroriale e gjyqësore. Me status ligjor dhe financiar, shumë më të lartë se vendorët, prokurorët dhe gjyqtarët e huaj kanë prodhuar më shumë psikologji për publikun sesa drejtësi, sepse janë kujdesur për rrethana tërësisht të papranueshme për drejtësinë, si: mospërgatitja e duhur e lëndëve dhe mospagësimi i duhur i provave. Kjo ka bërë që ata të mos flijohen në asnjë rast për prodhim të drejtësisë, por për prodhim të pasigurisë qytetare. Megjithatë, duhet thënë se EULEX-i e ka realizuar premisën e parë, duke mos shkëlqyer në të dytën. Kualiteti i drejtësisë matet me aktgjykime e jo me aktakuzat. EULEX-i ka rënë në batakun e aktakuzave dhe arrestimeve, por kur jemi tek aktgjykimet dënuese, ka ardhur në shprehje befasia në stilin e tyre të njohur për provat e pambrojtshme. Kjo nënkupton që aktakuzat janë ngritur mbi baza jo të mjaftueshme ligjore të cilat gjyqtarët i rrëzojnë shumë lehtë. Këto vendime patjetër që shfaqin një nivel të neglizhencës dhe pakujdesisë, që EULEX-i, si çdo mision tjetër ndërkombëtar, bën në përzgjedhjen e stafit të vet. EULEX-i duhet thënë se është mbreti i paragjykimeve. Ka lindur si mision i lirë për të punuar. Kam frikën se do të përfundojë si mision që preokupimin bazë e kishte fasadën, prapa së cilës fshihet paaftësia për të arritur rezultate. Përdorja nuk dallohet radikalisht në rezultate nga misioni pararendës i tij (UNMIK-u), identiteti i tij në pozitën shoqërore në Kosovë është i dobët. Domethënë që puna dhe produkti i këtij misioni është i zhveshur nga nevojat shumë të mëdha të Kosovës për

rend dhe ligj. Megjithatë, duhet thënë se EULEX-i nuk ka bërë sehire në tërë këto vite të funksionimit të tij. Ka trajtuar raste të rënda për rrethanat tona për shkak se vendorët vazhdojnë të funksionojnë sipas një rregulli mizor, që njihet si frikë dhe pasiguri në vendimmarrje. Fakti i vazhdimit edhe për dy vjet të tjera të mandatit të EULEX-it, do të thotë, mes të tjerash, se sistemi ynë i drejtësisë është i pamaturuar dhe i jo i gatshëm për t'u ballafaquar me nevojat e mëdha të Kosovës dhe të kosovarëve për rend dhe ligj.

"Epoka e re": *Z. Qorrolli, në mungesë të konsensusit Qeveria u detyrua ta tërheqë nga Kuvendi platformën për dialog. Në ditët në vijim mund të arrihet pajtueshmëri në mes të pozitës dhe opozitës? Si e shihni fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi, do të jetë ashtu siç po proklamohet nga politikanët tanë?*

Qorrolli: Thelbin e çoroditjes të dialogut politik Prishtinë - Beograd duhet ta lypim tek sëmundja kronike e Ballkanit për protagonizëm individësh dhe jo për strategji shtetërore të dialogut me një armik të dikurshëm me të cilin të kërkohet të pajtohesh. Duhet një doktrinë e re kombëtare e dialogut me Serbinë dhe ajo duhet të bazohet në ristrukturimin e thellë të formatit aktual të këtij dialogu, që tashmë është klinikisht i vdekur. Fletarrestimet e Serbisë janë dëshmia më mirë e këtij keqkuptimi të madh mes palëve dhe paaftësisë së Brukselit që t'i trajtojë të dyja palët baras. Për t'u bërë ndryshe dialogu, duhen emra dhe njerëz të tjerë nga ata aktualët, meqë punët e Kosovës kanë filluar të vështirësohen në arenën ndërkombëtare, sidomos pas rritjes së befasishme të partive të ekstremit të djathtë gjithandej Evropës të cilët, shumica prej tyre, janë kundërshtarë të krijimit të shtetit të Kosovës.

Së pari, dialogu Prishtinë - Beograd nuk mund të vazhdojë pafundësisht, pra duhet të ketë një pajtim paraprak për prioritetet dhe afata, gjë që me këtë format aktual nuk i ka asnjërin. Afatizimi i dialogut është çelësi i suksesit të tij. Nuk mund të negociohet pa kufi. Nëse qëllimi final i BE-së është traktati i paqes, pra pajtimi midis dy popujve e dy shteteve, atëherë ajo duhet t'i vë afat këtij dialogu se kur duhet të ndodhë ai pajtim.

Së dyti, dialogu ka nevojë për disiplinë mes palëve dhe kjo nënkupton që marrëveshjet e arritura deri më tash ose duhet të zbatohen 100 %, ose nuk duhet të

nënshkruhen fare vetëm sa për sy e faqe. Një marrëveshje ose zbatohet plotësisht, sepse nuk ka asnjë logjikë në marrëdhëniet ndërkombëtare që një marrëveshje bilaterale të zbatohet pjesërisht, ose të mos zbatohet fare. Kjo duhet të marrë fund njëherë e mirë.

Së treti, një dialog mes shtetesh nuk mund të jetë kurrë teknik. Dialogu çdoherë është politik, prandaj përfaqësimi duhet të rritet, ose me shefat e dy shteteve, ose në nivel kryeministrash. Me burokratë të rëndomtë, traktati i paqes mes dy shteteve, druaj se nuk do të ndodhë as në vitin 2100. Megjithatë, duhet thënë se diplomacia perëndimore nuk ka ç'të mësojë as nga Prishtina e as nga Beogradi. Skena aktuale e dialogut i ngjan atyre të Shekspir-it tek 'Makbethi': 'Gëzuar, o Makbeth, që nesër ngrihesh mbret!'. Në parafrazimin e kësaj, del se të gjitha të djeshmet e këtij dialogu kanë ndezur emocione dhe kanë çuar pluhur për ngacmime midis palëve, siç po ndodh këto ditë, me fletarrestimet e vjetra të Serbisë kundër ish-krerëve të UÇK-së.

Qëllimi final i Brukselit dhe Uashingtonit nuk është asnjë grimë më i vogël sesa pajtimi i dy popujve. Kjo politikisht i detyron të dyja palët të negociojnë por, jo pafundësisht, sepse një logjikë e tillë në marrëdhëniet ndërkombëtare çon në ndërlikim të mëtejshëm të raporteve. Dialogu ka shpresë po që se ristrukturohet sepse ky kualiteti ka humbur çdo kuptim. Për pajtim mes popujve, edhe Beogradi edhe Prishtina nuk duhet të dialogojnë me fantazmën e së kaluarës, siç po i ndodh aktualisht Serbisë. Ndërsa Kosovës i duhet një rregull më i madh në dialog, e ai është përfaqësimi më meritokratik e më dinjitoz. Me formatin aktual të dialogut, të tria palët, edhe Bashkimi Evropian si ndërmjetësues, edhe Serbia, edhe Kosova po bëjnë gabime të njëpasnjëshme, që për ta duket ironikisht janë gabime të lumtura. Duhet hequr dorë nga gabimet dhe duhet të arrihen rezultate të prekshme, të cilat i vërejnë qytetarët e të dyja vendeve. Imagjinojeni një marrëveshje për ngjitesit e tabelave të veturave, ku mund të lëvizni në Serbi me tabela 'KS', por jo me 'RKS' (siç!) dhe jo një marrëveshje për të pagjeturit ose për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Unë nuk jam për ndalimin e dialogut, por për rezultatet e tij. Rezultatet arrihen vetëm duke qenë palët e sinqerta mes vete dhe duke i respektuar marrëveshjet e arritura.

edhe me ata nga Lindja e Mesme. Këto dyndje popujsh janë 'koncerte të gjalla' të lirisë së njeriut dhe kërkesës për dinjitet. Evropa natyrshëm e ofron këtë mundësi dhe kosovarët nuk bëjnë përjashtim për të kërkuar një jetë më të mirë dhe më të dinjitetshme, të cilën vendi i tyre nuk ua ofron për faj të elitave të korruptuara politike. Kosova ka ende sfida serioze që kanë të bëjnë me korrupsionin, krimin e organizuar, modelin e saj të paqëndrueshëm ekonomik, çështjen e hapur

Kur vdes dëshmitari, vdes edhe rrëfimi për të, por jo edhe historia e tij



Nga Musa SABEDINI

Vdekja e dëshmitarëve që kanë përjetuar luftën, që kanë parë e dëgjuar tragjeditë familjare, që kanë përjetuar ankthin e trishtimin, që kanë përjetuar vrasjen e familjarëve të tyre, vrasjet e ngadalshme, dhunimet para syve të tyre, zhdukjen e familjarëve, që kanë parë mizoritë serbe me sytë e tyre, është e dhimbshme, është e pafalshme për një shoqëri dhe për institucionet e drejtësisë. Dëshmitarët e masakrave të rënda dhe të atyre që njihen si më të rëndat në Kosovë, në asnjë rast nuk është dashur të shkojnë nga kjo botë, pa u incizuar, pa u marrë deklarata

prej tyre dhe pa ofruar dhe deponuar dëshmi në polici, prokurori e gjykata. Dyshoj se shumë dëshmitarë të rëndësishëm, tashmë kanë vdekur, disa janë vetëm me kujtime nga e kaluara e disa ende vazhdojmë t'i injorojmë, edhe pse ata i kemi çdo ditë para syve tanë. "Dëshmitarët po vdesin", këtë titull pothuajse e kam shkruar hiq më pak se në vitin 2002, pra menjëherë pas luftës, kohë kjo kur dëshmitarët e krimeve serbe, ishin të freskët, kishin memorie të pastër, i njihnin të dyshuarit, dinin emra e mbiemra, kishin shënime të sakta, madje dhe foto të shumta. Me kalimin e kohës, dëshmitarët potencialë për çdo gjykatë ndërkombëtare filluan të harrohen, filluan të lihen pas dore. Policia, Prokuroria dhe Gjykatat nuk kishin guxim ose e kishin të ndaluar nga UNMIK-u që të hetonin mbi krimet serbe. Një lëshim katastrofal dhe i pafalshëm për Kosovën.

Betejën për ta mundur regjimin e Millosheviqit dhe ata kriminelë që ende jetonin të lirë, tashmë Kosova e kishte humbur. Mungonin dëshmitë, mungonin provat e deklaratat e deponuara. Gratë e vajzat e dhunuara, gjithashtu ishin të lëna pas dore. Thjesht, dëshmitarët duhej përpunuar dhe mësuar se si të kërkonin të drejtat e tyre. Më kujtohet nga gjykimi i Millosh Jokiçit nga Vitia, se si dëshmitarët kryesorë, tërë kohën e përsërisnin një fjali në gjykatore: "Zoti gjykatës, kur kryhet gjykimi se kemi për të punuar tokat tona". E dhimbshme gjithsesi, por e kuptueshme në aspektin njerëzor. Pse? Sepse asnjë avokat apo prokuror nuk e kishin përgatitur dëshmitarin. Nuk e kishin njoftuar se dëshmia e tij dhe e të tjerëve është thelbësore që të dënohen serbët e dyshuar. Kur vdes dëshmitari, vdes edhe rrëfimi i tij, vdes pjesa më

interesante e një tragjedie. Por, mbetet historia e tij dhe mbetet dëshmia e tij, sado që më e zbehtë. Ka ende dëshmitarë kyç në masakrat e Llashticës, Llovcës, por edhe në qytetet e tjera të Kosovës, që dinë shumëçka për krimet serbe dhe, ende heshtin. Ata nuk heshtin se nuk kanë çfarë të tregojnë, por heshtin sepse nuk ka kush t'i dëgjojë, sepse po heshtim të gjithë, sepse po bëjmë sehir të gjithë. I tërë orientimi mediatik, po edhe politik, sytë i ka të drejtuar nga Gjykata Speciale. Dhe i tërë munda i analistëve dhe i opinionistëve, fatkeqësisht orientohet në interesimet e tyre nëse ndaj Hashim Thaçit apo ndonjë komandanti tjetër të luftës do të ketë aktakuzë. Por askush nga ky tabor nuk e tha një rresht se qindra serbë të dyshuar po ecin lirshëm, po veprojnë madje edhe me deklarata publike. Askush nuk merret me ta. Pse? Sepse interesimi është i pakët për t'u marrë me këtë kategori.

Asnjëherë s'kam heshtur dhe nuk do të hesht. Nuk do të pajtohem, të paktën jo me dëshirë, që një shqiptar që e ka mbrojtur pragun e shtëpisë, edhe nëse ai ishte me uniformë, të akuzohet e gjykohet para një paramilitari serb, para një dhunuesi që ka emër e mbiemër. Të dyshuarit eventualë nga pala kosovare duhet t'i gjykojmë e dënojmë vetë, para se të gjykojnë nga të tjerët. Ende mendoj dhe shpresoj se dëshmitarët e gjallë i duhen drejtësisë, i duhen Kosovës dhe institucioneve të saja për t'u mbrojtur karshi propagandës serbe. Dëshmitarët posedojnë rrëfime autentike, rrëfime të gjalla, përshkrime të tmerrshme, kanë prova, kanë incizime në memoriet e tyre. Apeli im është që t'i duam këta njerëz, t'u japim guxim e fuqi që të deponojnë dëshmi në prokurori e gjykata. Madje edhe të paguhen, nëse është nevoja, sepse dëshmia e tyre s'ka çmim për drejtësinë.

Qeveria paguan rreth një milion euro dënime për kreditë e pashfrytëzuara

Prishtinë, 17 qershor - Qeveria e Republikës së Kosovës ka paguar 890 mijë euro si formë ndëshkimi për shkak të mostërheqjes së mjeteve financiare nga institucionet financiare ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës kishte nënshkruar marrëveshje për kredi me institucionet financiare ndërkombëtare në vlerë rreth 300 milionë euro për financim të 10 projekteve kapitale, por mjetet e zotuarat nuk janë tërhequr për shkak se projektet nuk kanë qenë të gatshme për financim, thonë zyrtarë të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Në një raport të publikuar nga kjo zyrë, thuhet se, si rezultat i kësaj, për mjetet e zotuarat dhe të pashfrytëzuara, Qeveria obligohet të paguajë pagesa shtesë (tarifa zotimi). Qerkin Morina, ndihmës i auditorit të përgjithshëm, tregon për "Radion Evropa e Lirë" se si pasojë e mospërputhjes së dinamikës kohore në mes të alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, vetëm për vitin 2017 vlera e paguar e tarifave të zotimit për mjetet e kredive të patërhequra nga huamarrësit arrin vlerën prej 890 mijë eurosh. "Sipas rezultateve të auditimit, Qeveria e Kosovës nuk ka qenë e gatshme t'i tërheqë borxhet e jashtme, në shumën prej 295 milionë eurosh. Dhe për

çdo vonesë në tërheqjen e këtyre kredive, Qeveria paguan një tarifë zotimi, e cila për vitin 2017 arrin në 890 mijë euro. Do të thotë, edhe pse fondet kanë qenë në dispozicion, nga 295 milionë euro, vetëm pesë milionë euro janë tërhequr, kurse më shumë se 97 për qind e fondeve janë të pashfrytëzuara", ka thënë Morina. Pagesën e shumës prej 890 mijë euro e kanë konfirmuar edhe zyrtarë të Ministrisë së Financave. Në një përgjigjeje përmes postës elektronike, thuhet se "shuma 890 000 euro përfshinë shumën që janë paguar në emër të tarifës së zotimit për projektet që janë në realizim e sipër. Do të thotë, tarifa e zotimit shoqëron kreditë edhe kur ato implementohen sipas planit të disbursimit, deri kur disbursohet shumën e fundit e asaj kredie", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Financave për "Radion Evropa e Lirë". Sipas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, Qeveria ka hyrë në borxhe kryesisht për financimin e projekteve rrugore, energjetike, rehabilitimin e linjave hekurudhore dhe përmirësim të sistemit të arsimit dhe shëndetësisë, projekte këto që kanë dështuar së realizuari. Vonesat e tilla, thotë Morina, janë rezultat i një studimi të



dobët të fizibilitetit të projekteve si dhe mangësitë në krijimin e parakushteve të nevojshme për eliminimin e të gjitha pengesave infrastrukturale dhe ligjore në realizimin e këtyre projekteve, për çka Qeveria duhet të ketë një mbikëqyrje të shtuar. Vlera e përgjithshme e borxhit të Kosovës këtë vit ka arritur mbi një miliard euro, që është për 9.1 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, borxhi ndërkombëtar dhe i brendshëm

i Kosovës ka një trend të rritje. Në vitin 2009 borxhi i përgjithshëm ishte 6.12 për qind e Bruto Produktit Vendor, ndërsa në vitin 2017 ka arritur mbi 16 për qind. Edhe ekspertë për çështje ekonomike konsiderojnë se Qeveria e Kosovës duhet të bëjë analiza dhe planifikime të hollësishme para se të fillojë procesi i marrjes së borxheve qoftë ndërkombëtar apo të brendshme. Qeveria e Kosovës në Ligjin e Buxhetit në vazhdimësi sipas viteve planifikon projektet që ka për qëllim t'i realizojë përmes

financimit nga huamarrja e jashtme. "Auditori ka ardhur në përfundim se analizat e projekteve që planifikohen të financohen përmes huamarrjes nuk janë të mjaftueshme. Një numër i projekteve kapitale për të cilat Qeveria ka hyrë në marrëveshje ndërkombëtare kredie nuk janë realizuar fare. Si rezultat, kanë filluar të paguhen shpenzime të tarifave të tjera apo tarifa të zotimeve për mjete të pashfrytëzuara", thuhet në raport, ndërkaq programet qeveritare ende janë në nivelin e ulët të realizimit.

Veseli kërkon në Francë mbështetjen e Parisit për liberalizim të vizave

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka udhëtuar të dielën për vizitë zyrtare në Francë, për ta kërkuar mbështetjen e Parisit për përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Gjatë qëndrimit në Paris, Veseli do të pritë nga drejtues të lartë të shtetit francez

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, të dielën ka udhëtuar për vizitë zyrtare në Francë, për ta kërkuar mbështetjen e Parisit zyrtar për përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave.

Gjatë qëndrimit në Paris, kryeparlamentari Kadri Veseli do të pritë nga drejtues të lartë të shtetit francez. Kryeparlamentari Veseli do të pritë në takim të veçantë nga presidenti i Asamblesë Kombëtare të Francës, François de Rugy. Njëpërmjet një komunikate për medie Zyra për Informim e Kuvendit të Kosovës ka bërë me dije se në këtë takim Veseli me homologun francez do të diskutojë për bashkëpunimin ndërshtetëror dhe atë ndërparlamentar, në mënyrë të veçantë për procesin e integriteteve evropiane të vendit, përkatësisht për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës gjatë këtij viti.

Po në kuadër të kësaj vizite delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryeparlamentari

Kadri Veseli, do të zhvillojë takim me kryetaren e Grupit të Miqësisë me Kosovën në Senatit francez, Marta de Cidrac, ndërsa do të pritë në një takim edhe nga kryetarja e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme të Asamblesë Kombëtare të Francës, Marielle de Sarnez dhe nga zëvendëskryetari i Grupit të Miqësisë në Asamblesë Kombëtare, Joachim Son Forget. Në këtë vizitë kryeparlamentari Veseli po shoqërohet nga përfaqësuesit e pozitës dhe opozitës.

Edhe në javën e kaluar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Strasburg për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Me këtë rast ai ka marrë përkrahjen e plotë për procesin e liberalizimit të vizave nga presidenti i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani.

Gjatë qëndrimit në Strasburg kryeparlamentari Veseli është pritur në takim edhe nga raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën, Tanja Fajon, me të cilën ka diskutuar rreth zhvillimeve aktuale në vend dhe



rajon, për procesin e integriteteve si dhe për liberalizimin e vizave. Me këtë rast, raportuesja Fajon ka thënë se Kosova tashmë ka përmbyllur të gjitha kriteret dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë gjatë këtij viti. Ajo ka bërë me dije se sapo Komisioni Evropian të dalë me raport pozitiv në fund të qer-

shorit, menjëherë në fillim të korrikut do të hyjë në agjendën e Komisionit të liberalizimit të vizave çështja e Kosovës. "Jam e lumtur që po e takoj kryetarin e Kuvendit të Kosovës për të diskutuar për hapat e ardhshëm për liberalizim të vizave. Përkrahja ime është e paekuvokë, sepse qytetarët e Kosovës meritojnë të udhëtojnë pa viza

në Zonën Shengen", ka deklaruar Fajon.

Po në vazhden e vizitës në Strasburg, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar takime të ndara me eurodeputetë të forcave të ndryshme politike, njëherësh raportues për vende të ndryshme të Ballkanit nga të cilët ka marrë mbështetje për heqjen e vizave për Kosovën.

Vazhdon të ketë listë të pritjes për operacione në zemër

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Aktualisht janë 100 pacientë në listë të pritjes të cilët duan t'i nënshtrohen intervenimit në zemër. Bëhet fjalë për Klinikën Kardiokirurgjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, e cila, pas shumë problemeve gjatë vitit të kaluar, arriti të funksionalizohet dhe ta vazhdojë punën me pacientë.

Prej atëherë janë kryer rreth 100 operacione dhe janë bërë mbi 500 stentime e 1 000 koronografi. Por, gjatë po këtij viti, tetë pacientë me probleme në zemër nuk kanë arritur ta presin trajtimin mjekësor, pasi kanë vdekur para se t'u vijë radha për operim. Bëhet fjalë për pacientë që ishin në listën e pritjes që nga viti 2016.

Megjithatë, ditën e mërkurë është funksionalizuar edhe një sallë operative dhe një dhomë e mjekimit intensiv, duke iu



shtuar këtij reparti, që funksiononte me vetëm një sallë operative.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se hapja e sallës së dytë operative do ta mundësojë edhe zvogëlimin e listës së pritjeve të pacientëve. Ai premtoi se edhe furnizimi me barna të listës esenciale do

të jetë stabil. "Jemi duke arritur të krijojmë shërbime më të shpejta dhe më cilësore për pacientët tanë, andaj sot e uroj të gjithë stafin këtu për punën të cilën e ka bërë, që ne të realizojmë këtë pas viteve e dekadave që nuk kanë pasur një mundësi të tillë dhe sot e kemi këtë mundësi që të ofro-

jmë, shtojmë këtë shërbim për pacientët", ka thënë Ismaili.

Tefik Bekteshi, kardiolog, ka thënë se janë në radhë të operohen rreth 100 pacientë, por ai shtoi se me hapjen e kësaj sale të dytë, numri i pacientëve që gjithmonë ka qenë i madh, për shkak të natyrës së sëmundjes, do të evitohet. "Deri tani, prej kur është funksionalizuar Kardiokirurgjia vitin e kaluar, 100 operacione janë kryer me një sallë. Me hapjen e sallës së dytë do të bëhet shumë më tepër. Kushtet e punës në këtë klinikë janë të shkëlqyera dhe jemi në shërbim të pacientëve", është shprehur Bekteshi. Edhe drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, ka bërë me dije se në këtë klinikë po bëhet punë e mirë, pasi numri i personave që kanë nevojë për trajtim në zemër, e që më herët

këtë shërbim e kanë kërkuar jashtë vendit, tash ky numër është zvogëluar dhe trajtimi po kryhet brenda Kosovës, përkatësisht në Klinikën e Kardiokirurgjisë në QKUK. "Të gjithë pacientët do të trajtohen në institucion publik. E mira është që kjo klinikë ka filluar punën 24 orë që nga shkurti i këtij viti, dhe menjëherë është vërejtur që pacientët në këtë periudhë nuk kanë dalë jashtë Kosovës për trajtim, dhe funksionalizimi i punës së sallës së dytë të Kardiokirurgjisë e me kapacitete të shtuara të intensive, e rritë vëllimin e punës", ka thënë Sejdiu.

Sidoqoftë, në Ministrinë e Shëndetësisë thonë se operacionet në zemër që janë kryer prej funksionalizimit të kësaj klinike, buxhetit të shtetit ia kanë kursyer mbi tre milionë euro.

Sektori financiar në Kosovë është stabil

BEÇIÇ, 17 QERSHOR (ER) - Në Beçic të Malit të Zi është mbajtur Samiti i ministrave të financave, guvernatorëve të bankave qendrore dhe drejtorëve të administratave tatimore të rajonit. Temë diskutimi e këtij samiti ishte "Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, dhjetë vjet pas krizës financiare globale".

Në fjalimin e tij para të pranishmëve, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se kriza globale ka imponuar ndryshimet në agjendat e bankave qendrore.

Guvernatori Mehmeti ka vënë në dukje se përderisa bankat qendrore të vendeve të zhvilluara aktualisht po ballafaqohen me sfidat e akomodimit të politikave monetare pas lehtësimit që kanë bërë gjatë dhe pas periudhës së krizës globale, për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, e cila ka një politikë monetare shumë të kufizuar si rezultat i eurizimit unilateral, sfida kryesore vazhdon të jetë ruajtja e stabilitetit financiar.

"Aktualisht ne kemi një sektor financiar shumë stabil dhe me përmirësim të vazhdueshëm të rolit të tij në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit. Norma e kredive joperformuese në sektorin bankar të Kosovës është vetëm 2.9% dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit është rreth 18%. Mirëpo, ne jemi të vetëdijshëm se tronditjet për sektorin bankar shumë shpesh vijnë prej jashtë bankave, pra prej ekonomisë, dhe në këtë aspekt ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm që bankat të mund t'u përballojnë tronditjeve të mundshme me të cilat mund të ballafaqohen në të ardhmen", ka thënë Mehmeti. Ai ka shtuar se sfidë tjetër për institucionin që drejton është edhe nevoja për rritjen e rolit të bankës qendrore në



ndikimin e zhvillimeve makroekonomike në vend. Guvernatori Mehmeti ka thënë se pjesa dërrmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës janë të denominuara në valutën euro, prandaj sektori është mjaft i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. "Ndikim shumë të rëndësishëm nuk kanë as lëvizjet e normave të interesit në tregjet ndërkombëtare për shkak se burimi kryesor i financimit të sektorit bankar të Kosovës janë depozitat e mbledhura brenda vendit, përderisa portofoli kreditor pothuajse në tërësi përbëhet nga kreditë e lëshuara brenda ekonomisë së vendit. Ngjashëm me eurozonën, edhe Kosova është përballur me norma të ulëta të inflacionit, madje edhe deflacion, në vitet e fundit", ka thënë

Mehmeti. Ai ka shtuar se mbizotërimi i çmimeve të ulëta në tregjet ndërkombëtare nuk e ka lënë pa pasoja as ekonominë e Kosovës, duke ndikuar negativisht sidomos industritë eksportuese. Një kujdes të veçantë, sipas guvernatorit Mehmeti, BQK-ja i ka kushtuar stabilitetit financiar duke zhvilluar kapacitetet mbikëqyrëse dhe duke filluar rishtazi aplikimin e qasjes së mbikëqyrjes të bazuar në rrezik. "Duke e ditur se mbikëqyrja mikroprudenciale, si e vetme, nuk vlerësohet më e mjaftueshme për t'i parandaluar krizat bankare, ne kemi zhvilluar edhe kornizën e politikës makroprudenciale dhe kemi funksionalizuar Komitetin Këshillimor të Politikës Makroprudenciale, si organ bartës i politikës makroprudenciale. Në Kosovë efektet

ndaj ekspozimit të sektorit të jashtëm kryesisht manifestohen në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave. Më konkretisht, efektet e tronditjeve nga jashtë reflektohen përmes remitencave, si dhe çmimeve të importeve dhe eksporteve. Po ashtu, kërkesa për eksporte pa dyshim se është një kanal i rëndësishëm por, marrë parasysh faktin se vlera e tyre ende mbetet mjaft e ulët, ndryshimi i kërkesës së jashtme ende nuk reflektohet në masë të madhe në Kosovë", ka thënë ai. Mehmeti ka theksuar se ngjashëm është situata edhe me investimet e huaja direkte, vlera e të cilave është relativisht e ulët dhe përbëhet në masë të madhe nga fitimet e mbajtura të kompanive të huaja që operojnë në Kosovë dhe nga investimet e diasporës

sonë në patundshmëri. "Në situatë të ngjashme ndodhet edhe sektori bankar, i cili pjesën dërrmuese të plasmanëve i bënë brenda ekonomisë së vendit, përderisa depozitat e mbledhura brenda vendit përfaqësojnë burimin e tij kryesor të financimit", ka thënë Mehmeti. Në këtë samit guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka kërkuar nga të gjithë homologët e vendeve të rajonit që të rritet më shumë bashkëpunimi mes bankave qendrore përmes formave të ndryshme, siç mund të jetë shkëmbimi i personelit për bartjen e njohurive të ndryshme ndërmjet bankave qendrore apo bashkëpunimi në zhvillimin e projekteve të përbashkëta të cilat mund të shfrytëzohen nga dy apo më shumë banka të rajonit.



Ende nuk dihet kostoja e heqjes së roamingut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

Njohësit e fushës së telekomunikacionit kanë bërë me dije se rezoluta për heqjen e roamingut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë mund të zbatohet vetëm pas marrëveshjes dypalëshe ndërmjet tyre, e cila arrihet në këtë rast nga dy ministrinë respektive që mbulojnë fushën e telekomit. Deri më tani ende nuk është bërë ndonjë studim në lidhje me heqjen e kostove të roamingut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën e propozuar nga grupi parlamentar i Partisë Socialdemokrate (PSD) që parasheh heqjen e roamingut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Rezoluta e miratuar parasheh që Qeveria e Kosovës në kuadër të integritimit ekonomik me Qeverinë e Shqipërisë t'i nisë procedurat për heqjen e tarifës së roamingut në telefoninë mobile ndërmjet qytetarëve të të dy vendeve. Kjo rezolutë parasheh themelimin e një komisioni të përbashkët Qeveri - Kuvend për t'i nisur bisedimet për eliminimin total të tarifave të roamingut në Kosovë dhe Shqipëri. Sipas kësaj rezolute, anëtarët e Kuvendit në këtë komision janë përfaqësues të secilit grup parlamentar në legjislaturën aktuale.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Telefonike dhe Postare të Kosovës dhe ai i Shqipërisë duhet të përkujdesen për implementimin e kësaj

marrëveshje. Po ashtu, kërkohet të thellohet bashkëpunimi në fushën e komunikimeve elektronike, me theks të veçantë në shërbimin e trafikut të internetit drejtpërdrejt njave shkëmbyese të internetit të dy vendeve.

Komisioni i përbashkët duhet të raportojë në Kuvend për arritjen e marrëveshjes dhe ecurinë e heqjes së tarifave jo më larg se dy muaj pas miratimit të kësaj rezolute. Lidhur me këtë rezolutë ka folur kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi.

Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rezoluta për heqjen e roamingut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë mund të fillojë së zbatuari vetëm pas marrëveshjes dypalëshe të ministrive përkatëse të dy shteteve. "Rezoluta për heqjen e roamingut në mes të Kosovës dhe Shqipërisë mund të zbatohet pas marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, e cila arrihet në këtë rast nga dy ministrinë respektive që mbulojnë fushën e



telekomit", ka thënë Gashi. I pyetur nëse do të duhej të kishte paraprakisht pajtim mes operatorëve, Gashi ka thënë se rezoluta e miratuar në Kuvend shpreh vullnetin e institucionit më të lartë ligjvënës në shtet për një çështje të caktuar siç është heqja e roamingut dhe bashkëpunimi me Shqipërinë në fushën e komunikimeve elektronike. Ndërkaq sipas tij, operatorët do të konsultohen për aspekte të implementimit të marrëveshjes nga ministrinë përkatëse gjatë procesit të pajtimit të hollësive teknike të zbatimit.

Sa i përket çështjes së kostos financiare të implementimit të kësaj rezolute, Gashi ka thënë se ende nuk është bërë ndonjë studim lidhur me heqjen e

roamingut në mes të dy shteteve. "Nuk është bërë ndonjë studim në lidhje me heqjen e kostove të roamingut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, por me gjithë kostot fillestare që mund të kenë operatorët, përfitimi për qytetarët e të dy vendeve nga heqja e roamingut është mjaft i madh për shkak të numrit të madh të lëvizjeve si dhe është në pajtueshmëri me trendin e zhvillimeve në rajon dhe në Bashkimin Evropian", është shprehur ai.

Ndërsa eksperti i telekomunikacionit, Agron Dida, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se rezoluta e miratuar në Kuvendin e Kosovës është një vendim i duhur dhe i mirëpritur

për qytetarët e të dyja shteteve, pasi çmimet aktuale janë të larta. "Rezoluta është vendim shumë i duhur për qytetarët dhe bizneset në të dy shtetet. Kjo rezolutë është në pajtim me trendet e zhvillimeve në EU, pasi edhe atje u hoq tarifa roaming mes shtatëve të EU-së", ka thënë Dida. Sipas tij, vendim të njëjtë duhet të marrë edhe Kuvendi i Shqipërisë. "Këtë vendim duhet ta marrë edhe Kuvendi i Shqipërisë në mënyrë që rregullatorët e Telekomit të mund të sajojnë rregulla të reja të komunikimit për operatorët sipas kërkesave të kuvendeve përkatëse. Çmimet aktuale janë të larta dhe duhet të rregullohen", është shprehur Dida.

Breshëri në Rahovec ka dëmtuar sektorin bujqësor

RAHOVEC, 17 QERSHOR - Reshjet e shiut dhe breshri kanë shkaktuar miliona euro dëme në qytetin e Rahovecit dhe fshatrat përreth. Për t'i përballuar dëmet, nevojitet ndihma e Qeverisë, pasi buxheti i kësaj komune nuk ka fonde të mjaftueshme. Përveç dëmeve në vreshta dhe kultura bujqësore të shkaktuara nga breshëri dhe shiu i madh, ka pasur dëme edhe në amvisëri dhe biznese. Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka deklaruar për "Kosovapress" se urgjentisht nevojitet fondi për investime të dëmeve dhe sis-

temit anti-breshër. "Si pasojë e motit të lig bujqësia në Komunën e Rahovecit është goditur aq shumë sa që nuk dihet se si do të mbijetojnë fermerët që kanë pësuar dëme", ka thënë Latifi.

Edhe kryetari i fshatit Krushë e Madhe, Selami Hoti, ka shprehur shqetësimet e tij për banorët e asaj ane, të cilëve u janë shkaktuar dëme të shumta pas vërshimeve. Për sanimin e kësaj situatë dhe mënyrën që të zvogëlohen dëmet, Hoti ka thënë se nevojitet mbështetja e Qeverisë, pasi ka familje që jetojnë vetëm nga bujqësia.



Komuna e Mitrovicës, UN-HABITAT-i dhe PAX-i nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

MITROVICË, 17 QERSHOR (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, në emër të Komunës së Mitrovicës, Gwendoline Mennetrier, në emër të UN-Habitat-it dhe Michael James Warren, në emër të PAX-it, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e projektit "Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës", financuar nga Agjencia Suedeze (SIDA).

Qëllimi i këtij takimi është nxitja e zhvillimit gjithëpërfshirës dhe qeverisja e mirë nëpërmjet zhvillimit të planifikuar dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit, me komunitete të integruara në të gjitha fazat e planifikimit dhe zbatimit në kuadër të bashkëpunimit efikas ndërkomunal dhe qeverisjes në shumë nivele. Projekti "Nxitja e zhvillimit gjithëpërfshirës dhe qeverisjes së mirë në Kosovën veriore" ka

disa faza. Projekti ka për synim avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm të komunave partnere nëpërmjet proceseve strategjike; fuqizimin e kontratës shoqërore përmes rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së pushtetit lokal; përkrahjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe lokal - qendror, fuqizimin e kapaciteteve të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile etj.



Mbahet tryeza shkencore "Mendimi politik e shkencor i Ukshin Hotit për zgjidhjen e çështjes shqiptare në kontekstin evropian"

Ukshin Hoti mbetet ndër figurat madhore të kombit

"Ukshin Hoti mbetet ekzemplar i rrallë dhe ndër figurat madhore të kombit tonë", ka thënë të dielën kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, në tryezën shkencore "Mendimi politik e shkencor i Ukshin Hotit për zgjidhjen e çështjes shqiptare në kontekstin evropian", e cila është organizuar në 75-vjetorin e lindjes së tij



Thaçi: Ukshin Hoti frymëzoi shumë breza për lirinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka përkujtuar veprimtarin e madh të lëvizjes kombëtare, Ukshin Hoti, në 75-vjetorin e lindjes së tij. Ai ka thënë se me guximin politik dhe intelektual, Ukshin Hoti ka frymëzuar shumë breza për ta ngritur zërin e protestës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Sot është 75-vjetori i lindjes së Ukshin Hotit, veprimtarit të madh të lëvizjes sonë kombëtare. Me guximin politik dhe intelektual Ukshin Hoti frymëzoi shumë breza për ta ngritur zërin e protestës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ndonëse nuk dihet fati i tij dhe i mijëra të pagjeturve të tjerë, filozofia politike e Ukshin Hotit është pjesë e historisë moderne të shtetit tonë. Ne s'do të ndalemi asnjëherë së kërkuari bijat dhe bijtë tanë, derisa të dihet fati i tyre dhe të vendoset drejtësia për ta", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA E Qendresa RAMA

RAHOVEC, 17 QERSHOR - Me rastin e 75-vjetorit të lindjes së profesor Ukshin Hotit, në Krushë të Madhe, në Shtëpinë e Kulturës, është mbajtur të dielën tryeza shkencore "Mendimi politik e shkencor i Ukshin Hotit për zgjidhjen e çështjes shqiptare në kontekstin evropian".

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se të mëdhenjtë, heronjtë dhe martirët, kanë vetëm ditëlindje. Ai ka thënë se vepra e Ukshin Hotit ishte bërë frymëzuese për njerëzit e rezistencës shqiptare kundër shtypjes e represionit serb, të maskuar nën maskën e komunizmit jugosllav në fillim të viteve 1980. "Mënyra e argumentimit të idesë për Republikën e Kosovës, faktet bindëse dhe të mbështetur mbi të dhëna shkencore, e sfiduan sistemin 'e vlerave' të Jugosllavisë së asaj kohe. Mirëpo, regjimet shtypëse e totalitare nuk e pranojnë forcën e argumentit,

prandaj edhe njerëzit mendjendritur, siç ishte Ukshin Hoti, duheshin hequr nga skena. Qëndrimi i tij stoik e vetëmohues, i bindur në të drejtën e tij dhe të popullit të tij, bënë që figura e tij të imponojë respekt", ka thënë Latifi në këtë tryezë shkencore, e cila është organizuar nën përkujdesjen e tij.

Latifi ka theksuar se Ukshin Hoti qëndronte shumë më lart në pikëpamje të njohurive politike shkencore sesa klasa politike e asaj kohe. "Idetë e tij kërkonin konsistencë e guxim për t'u zbatuar. Pikërisht këto i sollën gjithë ato krajata e mundime, por nuk e thyen dot. U bë simbol i qëndresës e përkushtimit dhe si i tillë do të mbahet mend gjatë. Kjo qëndresë e bëri të jetë i pavdekshëm, pavarësisht se kur do të vinte vdekja natyrore, ashtu siç do të vijë për secilin njeri të vdekshëm", është shprehur Latifi, duke shtuar se Ukshin Hoti e dinte mirë ç'do të thotë të krijosh shtet që merr në mbrojtje qytetarët e vet. "Kjo e bën të veçantë

profesorin Hoti e aktual edhe në ditët tona. Largpamësia dhe mbështetja në të dhëna shkencore e të dokumentuara janë veti e shkencëtarëve, prandaj themi se profesori ynë ishte shkencëtar i politikës nga i cili mund të mësohet ende", ka thënë ai.

Kryetari i Rahovecit ka shtuar se trajtimi i pikëpamjeve të Ukshin Hotit, ruajtja e trashëgimisë së tij, ruajtja e relikteve të tij, janë ndër obligimet tona morale e institucionale. "Përfundimi i projektit të shtëpisë muze, mbledhja dhe sistemimi i veprimtarisë së tij, po ashtu janë ndër obligimet që presin të përmbushen. Krejt kjo në kujtim të asaj shëmbëlltyre që

duhet ta ketë çdo komb i civilizuar dhe që duhet t'u lihet trashëgim brezave. Pasardhësit duhet ta dinë rrugën nga kanë kaluar heronjtë dhe martirët tanë, sakrificat që kanë bërë dhe vuajtjet që kanë përjetuar, vetëm që të mos i mbeten borxh historisë. Secilit pjesëtar të këtij komuniteti i takon ta vlerësojë, çmojë e ruajë këtë trashëgimi, ngaqë historia mund të përsëritet dhe të jetë më tragjike. Që të mos na ndodhë kjo, duhet të kujdesemi për ato që na lanë paraardhësit tanë, ndërsa Ukshin Hoti mbetet ekzemplar i rrallë dhe ndër figurat madhore të kombit tonë", ka thënë Latifi.

Kjo javë do të jetë edhe me shi

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se moti në pesë ditët e ardhshme do të jetë i vranët dhe me intervale me diell.

"Vendi ynë do të vazhdojë të mbetet nën ndikimin e masave të ajrit me presion të ndryshueshëm atmosferik. Në këtë situatë meteorologjike do të mbajë mot i vranët dhe me intervale me diell. Vranësirat


gjatë ditës nuk do të jenë stabile duke krijuar kushte për reshje lokale shiu dhe shkarkime rrufesh", është thënë në njoftimin e IHMK-së. Sipas këtij njoftimi, nga e premtja do të ketë çrregullim të motit. "Të mërkurën dhe të enjten do të mbajë mot me intervale më të gjata me diell dhe mundësitë për reshje do të zvogëlohen, mirëpo nga dita e premtë e tutje sërish do të ketë

çrregullim të motit, vranësira të dendura dhe kushte të favorshme për reshje shiu dhe shkarkim rrufesh.

Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet 13-16 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihet të lëvizin ndërmjet 24-27 gradë celsius. Do të fryjë erë nga verilindja dhe veriperëndimi me shpejtësi deri 9m/s", është thënë në këtë njoftim.



MILIONERËT POLITIKË DHE TË VARFRIT



Rexhep QOSJA

Kosova e Re, shtet i lirë e i pavarur, por me sovranitet ende të gjymtuar, ka mjaft risi. Një prej këtyre risive të Kosovës së Re janë milionerët e saj. Në mendjen time është krijuar pamja e dy lloj milionerëve të Kosovës së sotme: pamja e milionerit, të milionuar, domethënë të pasuruar, me djersë, me mund, me aftësi punuese e menaxhuese, në njërën anë, dhe pamja e milionerit të milionuar, të pasuruar turr, vrap, me punë politike, domethënë në sajë të pozitave politike, në të vërtetë duke shfrytëzuar e duke shpërdoruar pozitave politike e shtetërore!

Milionerët e llojit të dytë, të pasuruar në sajë të pozitave politike, janë temë çdo ditë e më e shpeshtë e bisedave, në të vërtetë ende më shpesh e pëshpëritjeve sesa e bisedave të hapëta të qytetarëve.

Dua të them disa fjalë për këtë milionerin tonë politik sjellje-harlisur, të pasuruar në mënyrë tragjikomike, në sajë të posteve politike e shtetërore!

Po i dëgjoj çdo ditë milionerët politikë duke qarë e vajtuar hallet e të varfërve.

Vajet e këtyre "humanistëve", këtyre "shpirtmirëve" politikë për të varfrit sot janë më të shpeshta dhe më të zëshme se para një viti!

Nuk e kuptoj plotësisht arsyen e këtij "njerëzillëku" të tyre!

Në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës është shtuar numri i milionerëve politikë që qajnë hallet e të varfërve, kurse në Kosovë po shtohet çdo ditë e më shumë numri i të varfërve.

Në Kuvendin dhe në Qeverinë e Kosovës është shtuar numri i milionerëve politikë, që qajnë e vajtojnë hallet e të varfërve, kurse në Kosovë është shtuar numri i të rinjve e të rejave që bëjnë çmos për të ikur prej atdheut të vet e për të gjetur shpëtim nga skamja në Evropë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në

Kanada, në Australi, në Zelandë të Re, në Turqi, në Japoni apo, madje, edhe në Korenë e Jugut.

Çfarë cinizmi tragjikomik përmban ai vajtim i milionerëve politikë e shtetërorë!

Milionerët tanë politikë, të pasuruar, krijuesit e fjalëve të reja, do të mund të thoshin edhe të milionuar, në sajë të pozitave politike, që u janë dhuruar gjatë votimeve vendore a të përgjithshme, kur e kur edhe vendore dhe të përgjithshme, po i vajtojnë hallet e shtuara të të varfërve jo vetëm shpesh, jo vetëm me shumëkënd, por edhe shumëkënd: në mbledhje partiake, në mbledhje jopartiake, në takime e konferenca të ndryshme, në biseda me gazetarët e televizioneve e të gazetave, me vendorë e të huaj e, sidomos, në kuvendet komunale dhe në Kuvendin e Kosovës, por numri i të varfërve po shtohet me gjithë sasinë e madhe të lotëve të milionerëve!

Çfarë ironie përmban kjo shumësi tragjikomike lotësh!

Milionerët tanë politikë po ua qajnë hallet jo vetëm të varfërve të rinj, po edhe të varfërve të vjetër, kurse vaji i tyre për varfërinë e të vjetërve e të vjetrave është më i lotpaktë. E kuptueshme: e dinë se s'do të vajtojnë gjatë për varfërinë e tyre!

Milionerët tanë politikë kohët e fundit po qajnë hallin jo vetëm të të varfërve të të gjitha moshave, po edhe të të varfërve të të gjitha gjinive - të gjinisë mashkullore e të gjinisë femërore

Sa i gjithanshëm na është bërë "njerëzillëku" i milionerëve tanë politikë!

Milionerët tanë politikë po qajnë e vajtojnë hallet e të varfërve të të gjitha gjinive dhe të të gjitha moshave më së shpeshti duke qeruar hesape politike e partiake me kundërshtarët qoftë kur janë në opozitë, qoftë kur janë në pozitë. Dhe këta të opozitës na mësojnë se numri i të varfërve është shtuar, kurse vetë varfëria është thelluar prejse kjo, pozita, e ka marrë pushtetin, ndërsa këta të pozitës na mësojnë se numri i të varfërve është shtuar e varfëria në përgjithësi është thelluar në kohën kur kjo, opozita e tashme, ishte në pushtet!

Sa mirë e njohin "historinë" e

këtyre ditëve dhe sa shumë e duan të drejtën milionerët tanë politikë të pasuruar në mënyrë komike për ta, por gjithnjë tragjikomike për shtetin e Kosovës.

Milionerët tanë politikë, të milionuar në sajë të pozitave politike e shtetërore, që kishin dhe që vazhdojnë të kenë, po qajnë hallet e të varfërve të të gjitha gjinive e të të gjitha moshave kurse, pa shikuar djathtas a majtas, po punësojnë të vetët: familjarët e vet, shokët e vet, miqtë e vet, puthadorësit dhe puthakëmbësit e vet pa marrë parasysh sa e meritojnë atë punësim ata!

Çfarë "njerëzillëku" duçe-ist përmbajnë vajtimet e milionerëve tanë politikë për të varfrit!

Milionerët tanë politikë po e vajtojnë gjendjen e të varfërve të Kosovës, kurse pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të familjarëve, të të afërmeve dhe të miqve të tyre, po shtohen gjithnjë e më shumë dhe po shtohen në sajë të posteve dhe marifeteve të milionerëve tanë politikë!

Sa demokratike është politika familjare dhe fafëfisnore e milionerëve tanë politikë!

Milionerët tanë politikë vazhdojnë t'i qajnë hallet e të varfërve tanë, numri i të cilëve sado vjen e shtohet, kurse privilegjet e ndryshme, të shumëllojshme e të gjithëkohshme të milionerëve, po ashtu po shtohen dhe po shtohen në përpjesëtim të drejtë me shtimin e numrit të të varfërve!

Sa shumë i duan të drejtat e punëtorëve dhe sa shumë e duan shtetin social këta milionerët tanë politikë e shtetërorë!

Milionerët tanë politikë po qajnë zëshëm, gjithnjë e më zëshëm, hallet e të varfërve tanë, kurse shkëlqesitë e tyre dhe lartmadhëritë e tyre janë gjithnjë e më të shkëlqesishme dhe më të lartmadhërishme jo vetëm në Kosovë, jo vetëm në Kosovë e në Shqipëri, jo vetëm në Kosovë e në Maqedoni, jo vetëm në Kosovë e në Luginë të Preshevës, jo vetëm në Kosovë e në Mal të Zi, por edhe në një varg shtetesh të Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës!

Sa tragjikomikisht përshtypjebërës është ky vajtim i milion-

erëve tanë politikë për të varfrit!

Milionerët tanë politikë, të milionuar në sajë të pozitave politike të cilat u janë dhuruar prej votuesve e ndonjëherë janë përvetësuar pa votime, po e qajnë hallin e të varfërve në njërën anë, kurse në anën tjetër po u shtohen punët e llojeve të ndryshme jo vetëm partiake, politike e shtetërore, por edhe arsimore, shkencore, turistike, me shkuarje e ardhje të shpeshta, kombëtare e ndërkombëtare, që u sjellin rroga, honorarë, mëditje, çmime, përfitime ditore e gjatëkohore, që s'harrohen! Sa tragjikomike, ironike, cinike, më shumë tragjike sesa komike, është demagogjia e milionerëve tanë politikë!

Deri kur të varfrit e Kosovës do të durojnë lotët e krokodila të milionerëve politikë për gjendjen e tyre të mjeruar; deri kur do të durojnë lotët e krokodila të milionerëve politikë të cilët postet politike e shtetërore i kanë përdorur e shpërdorur e kriminalizuar për t'u bërë vrap me miliona, me toka të reja, me shtëpi e pallate, me nga tri, katër, pesë banesa, me restorante, me pompa të benzinës, me vila në bjeshkë e në bregdet, me lokale afariste, me vetura të shtrenjta e me prona të tjera të ndryshme ende të paemërtuara! Nuk e di! Por, e di se shpejt, më shpejt se ç'e mendoja, po bëhemi shoqëri politike në të cilën asgjë nuk është e turpshme përpos që të jesh i varfër, i varfër dhe, për shkak të varfërisë, i shpërfillur dhe i nënçmuar prej milionerëve politikë të pasuruar, të shumëmilionuar, në sajë të pozitave politike e shtetërore zhvatëse.

E interesi i qytetarëve të Kosovës, i të gjithë shqiptarëve, kudo qofshin ata, është që Kosova sa më parë të bëhet shtet demokratik, pa autoritarizmin që e mundon shumë sot, shtet demokratik me administratë publike të papartisuar, me gjyqësor vërtet të pavarur që, përpos të tjerash, i mbron firmat private prej reketimeve e shantazhimeve nga njerëzit e pushtetit që, përpos të tjerash, mbron statusin e pambrojtur të punëtorëve në këto firma, që me vendimet e veta komprometon lotët e rrejshëm të milionerëve politikë për të

varfrit, që merr masa ligjore ndaj të zhyturve në konflikt interesi, që merr masa ndaj abuzuesve të tenderëve. E të tjera.

Është interes i qytetarëve të Kosovës, i shqiptarëve kudo qofshin ata, që edhe Kosova, si vendet vërtet demokratike, të ketë Ligj për prejardhjen e pasurisë, në sajë të të cilit do të hulumtohet sidomos pasuria e funksionarëve të lartë shtetërorë, duke përfshirë këtu, natyrisht, edhe kryetarin dhe kryeministrin. Dhe, si shtet me korrupsion pandemik, si e kanë theksuar sa e sa herë autoritetet e BE-së, të ketë edhe prokurorin e pavarur, i cili do ta hulumtojë prejardhjen e asaj pasurie të funksionarëve të lartë, të "peshqve të mëdhenj" si i quajnë të varfrit dhe ndërkombëtarët oligarkët politikë të pasuruar, të milionuar, me poste të larta politike e shtetërore duke rjepur Kosovën!

Është interes i qytetarëve të Kosovës, i shqiptarëve kudo qofshin ata, që Kosova të bëhet shtet demokratik e sovran, në të cilin nuk do të ketë poltronizëm politik e shtetëror me pasoja kombëtare: shtet në të cilin nuk do t'u bëhet e mundshme atyre që po derdhin lot të rrejshëm për të varfrit sot, që me poltronizmin e dëshmuar në vazhdimësi, dhe duke flijuar interesa kombëtare, të përfitojnë përkrahje ndërkombëtare për ta vazhduar karrierën e tyre pushtetore tragjikomike eksploatuese!

Deri atëherë intelektualët që kanë mendjen për mendim të pavarur do të duhej të jenë me të varfrit e të varfër, të varfër për të cilët nuk vajtojnë milionerët politikë!

Ashtu intelektualët do të varfëroheshin materialisht, por do të ngriteshin shpirtërisht dhe moralisht!

Dhe, këtë ngritje shpirtërore e morale do ta shquanin e do ta dëshmonin edhe më shumë po të shkruanin romane, drama, monodrama me personazhe milionerë politikë e të varfër, përmes të cilëve do të paraqiteshin gjithë kundërshtitë tragjikomike në Kosovë sot.

Edhe milionerët politikë edhe të varfrit e Kosovës e dinë, besoj, se romane, drama, monodrama e vepra të tjera mos sot nesër për ta do të shkruhen!

E rrallë

Shembet tavani, turistët vrapojnë për ta shpëtuar jetën

Të paktën nëntë turistë janë plagosur pasi një çati u shemb derisa po ecnin në një shkallë lëvizëse. Ngjarja ndodhi të dielën në qendrën turistike të malit Huashan në Kinë. Çasti i frikshëm është filmuar edhe nga kamerat e sigurisë.



FOTO E DITES



Pamje e një liqeni në bukuritë e bjeshkës së Rugovës.
/Foto: Granit Dinaj/

E jashtëzakonshme

Gruaja gjen në makinë gjarprin gjigant

Një grua në Kinë është tmerruar kur ka parë se në makinën e saj gjendej një gjarpër. Pitoni i madh ishte fshehur në pjesën e përparme të automjetit. Më pas gjarpri u kap nga një ekspert zvarranikësh dhe oficerët e policisë lokale.



DASHI
Në raportin në çift gjërat

duhet të sqarohen njëherë e mirë. Jeni munduar shumë herë të thërrisni në bashkëbisedim partnerin, por nuk ia keni dalë.



DEMI
Do të shteroni në maksimum njohjet

dhe kapacitetet tuaja sot për një ngjarje të caktuar. Për të ndihmuar një mik mund të bëni çdo gjë.



BINJAKËT
Dita juaj nuk do të kushtëzohet nga

suksesi sot, por nga përkushtimi që do të jepni në një situatë të caktuar. Nëse nuk ju pëlqen, që në fillim do ta injoroni.



GAFORRJA
Sot në fund të ditës do të ndiheni

shumë të kënaqur me vendimet që keni marrë dhe me përparimet që po bëni. Dëshironi ta shijoni shtëpinë sonte.



LUANI
Mbase duhet të besoni më shumë

tek personat që ju mbështesin gjithmonë. Duhet t'i rivendosni ekuilibrat e humbur.



VIRGJËRËSHA
Nëse në plan të parë keni vënë

interesat tuaja sot, nuk duhet të mërzhiteni nëse dhe të tjerët zgjedhin të njëjtën rrugë për veten e tyre.



PESHORJA
Mos kini frikë të humbni atë që nuk

është e juaja. Të jeni të sigurt që sot nuk do të humbni asgjë të rëndësishme vetëm do të çlirohemi nga një barrë.



AKREPI
Ka mure që nuk mund t'i kaloni dot

pavarësisht prej sjelljes suaj. E rëndësishme është që ju provuat çdo mënyrë dhe nuk e keni në dorë rezultatin.



SHIGJETARI
Sot nuk do të jetë dita juaj më e mirë,

por mund të bëni të mundur që kjo gjë të mos përsëritet edhe nesër. Merrni masat të neutralizoni çdo gjë.



BRICJAPI
Çdo shenjë e vogël nga persona

që ju pëlqen që ju pëlqen mund t'ju duket një ftesë për shoqëri. Jo gjithmonë është e saktë, kështu që qëndroni me këmbë në tokë.



UJORI
Mund të merrni vendime më të mira

se ato që keni marrë deri tani. Kështu që mos u tregoni të tërhequr. E ardhmja juaj është më e rëndësishmja.



PESHQIT
Përpikuni të relaksoheni pak

në këto çaste të jetës suaj dhe të mendoni se çfarë keni bërë deri tani dhe çfarë do të bëni në të ardhmen.

BARSOLETA E DITËS



Bisedojnë dy shoqe:

- Sa kilogramë i ke?
- Pesëdhjetë e diçka.
- Sa diçka?
- Pesëdhjetë e njëzetë e pesë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

“ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

“I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



FORÇA JONË

* * * Viti VII • Nr. 69 • 10 Qershor 2018 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

FSK-ja përfundoi me sukses ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6"



Udhëheqës shtetërorë dhe ushtarakë të Kosovës dhe të shteteve partnere më 11.05.2018, vizituan operacionet përfundimtare të ushtrimit fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6", në Kastriot, Batllavë dhe Koliq. Fillimisht në mjediset e ministrisë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, priti gjeneralët dhe oficerët e shteteve partnere dhe drejtuesit e agjencive të Kosovës, të cilët i falënderoi për bashkëpunimin, koordinimin dhe ndërveprueshmërinë gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 6", ushtrim ky, i pari i këtij lloji, i planifikuar dhe ekzekutuar nga FSK-ja në bashkëpunim me agjencitë vendore dhe ushtritë partnere nga shtete të ndryshme.

Drejtori i ushtrimit fushor "Shqiponja 6", gjeneral brigade Naim Haziri, për udhëheqësit shtetërorë dhe ushtarakë shpjegoi kon-

ceptin, objektivat, skenarin e ushtrimit më të madh vjetor të FSK-së, urdhrin operacional, javën akademike, pritjen dhe atashimin e kontingjenteve të shteteve mike në njësitë e FSK-së, dislokimin e njësisve, ngritjen e kampit, funksionalizimin e komandës së përparme, atë të planifikimit si dhe me aktivitetet të tjera të ushtrimit ndërkombëtar "Shqiponja 6".

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ambasadori i SHBA-ve, Greg Delawie, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Timothy Orr, zv. ministri i Mbrotjtjes të Maqedonisë, Bekim Maksuti, zv. ministri i FSK-së Agim Çeku, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK(N-ALT), gjeneral brigade Ralf Hofman, atasheu amerikan në Kosovë, koloneli Jeffry Fischer, gjeneralë të FSK-së, eprorë të lartë të Policisë së Kosovës, drejtues të agjencive të Kosovës për emergjenca, ushtarakë të shteteve mike pjesëmarrës në ushtrim fushor, fillimisht vizituan vend-incidentin e parë në Korporatën Energjetike të Kosovës në "Kosova A", ku ishin simuluar skenarë të reagimit emergjent, pastaj vizituan lokacionin në Batllavë, tek penda ku dyshohej, sipas skenarit, për mjete

eksplozive si dhe materie të rrezikshme të vendosura nga grupe kriminale.

Te Penda e Batllaves, aty

kontribuojë në garantimin e një ambienti të sigurt si në vend ashtu edhe në rajon e më gjerë".

tarakë vizituan edhe Komandën e përparme të ushtrimit në Koliq, ku u priten nga komandanti i Brigadës për



ku u demonstruan operacionet përfundimtare, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Rrustem Berisha, tha: "Me këtë ushtrim, FSK-ja po dëshmon se ka avancuar me sukses si dhe ka dëshmuar fuqishëm se është Forcë e ndërveprueshme me ushtritë e vendeve partnere dhe se është e gatshme që të

Gjithashtu edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama e vlerësoi lart zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të ushtrimit, duke shprehur admirimin për një bashkëpunim dhe koordinim të të gjithë aktorëve në ushtrim, e sidomos ndërveprueshmërinë gjatë realizimit dhe ekzekutimit të skenarëve të ushtrimit. Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerali Rrahman Rama, tha se sukcesi i ushtrimit është edhe një dëshmi se FSK-ja është e gatshme të marrë detyra të reja.

Nga ana e tij, ambasadori i SHBA-ve, Greg Delawie deklaroi se: "Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë krenare që kanë punuar përkrah Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe së bashku edhe me gjashtë shtete tjera, për të organizuar këtë ushtrim". Më tej, ambasadori Delawie tha: "Gjithsej 88 ushtarakë amerikanë janë të përfshirë në ekzekutimin e ushtrimit "Shqiponja 6", gjatë dy javëve të shkuara. Jam tepër krenar me punët e përbushura nga ushtarakët tanë dhe partnerët ndërkombëtarë".

Më pas, udhëheqësit ush-

Reagim të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj. Ndërsa, për ecurinë e ushtrimit fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" i njoftoi komandanti i forcës në detyrë, nënkolonel Sylejman Cakaj, njëherësh edhe komandant i Batalionit të Tretë të Reagimit të Shpejtë.

Në fund, pjesëmarrësit e rreshtuar në ushtrim, i falënderuan komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneral majori Timothy Orr.

Në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6", me njësi ushtarake morën pjesë: Garda Kombëtare e Ajovës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kontingjente nga Kroacia, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Maqedonia dhe Republika e Shqipërisë, të cilat u atashuan në njësitë e FSK-së, pastaj Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Kryqi i Kuq i Kosovës.

Në ushtrimin fushor ndërkombëtar "Shqiponja 6" gjatë dy javëve sa zgjati ushtrimi morën pjesë gjithsej 1167 ushtarakë me mbi 147 automjete.



Ministri dhe komandanti i FSK-së priten zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të Komandës së Bashkuar për Evropë të Ushtrisë së SHBA-ve

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së gjeneralallejtënant Rahman Rama, më 11.05.2018, kanë pritur në mjediset e ministrisë zëvendësshefin e Politikave dhe Planeve të Komandës së Bashkuar për Evropë të Ushtrisë së SHBA-së, gjeneralbrigade Michael Turello, i cili shoqërohej nga një delegacion i gjerë ushtarakësh.

Gjenerali Michael Turello është ngarkuar, nga komandanti i Komandës së Bashkuar për Evropë të Ushtrisë së SHBA-së, që të marrë pjesë në ushtrimin fushor "Shqiponja-6".

Ministri Berisha ka falënderuar



gjereralin Turello për bashkëpunimin dhe ndihmën që SHBA ka dhënë dhe po jep për

Kosovën dhe në veçanti për FSK-në. Ai me këtë rast e ka informuar gjeneralin Turello me të ar-

riturat e FSK-së; duke nënvizuar faktin se FSK-ja për vitin e pestë me radhë nga publiku vendor është vlerësuar si institucioni më i besueshëm i sigurisë; shkallën e integritetit të komuniteteve pakicë, i cili aktualisht është mbi 10%; integrimin e suksesshëm të komunitetit serb; përfaqësimin e mirë të gjinisë femërore, e cila është mbi 8%, duke përmendur edhe faktin se nga marsi i këtij viti kemi femrën e parë që bartë gradën e gjeneralit.

Ministri Berisha ka folur edhe për nivelin e mirë të bashkëpunimit me shtetet fqinje dhe të rajonit, angazhimin në Kartën e Adriatikut A-5, ku Kosova dhe

FSK-ja pretendojnë të kenë statusin e pjesëmarrësit me të drejta të plota. "Kur bashkëpunimi është i mirë dhe i gjerë në mes të shteteve të rajonit edhe situatat emergjente mund të përballohen më lehtë.

Nga ana e tij, gjenerali Turello ka përgëzuar ministrin Berisha dhe FSK-në për arritjet e deritashme. Ai ka premtuar se bashkëpunimi dhe ndihma nga Ushtria e SHBA-së do të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke e vlerësuar pjesëmarrjen e Kosovës në mekanizmat rajonale të sigurisë si një çështje vitale për sukseset e rajonit.

Komandanti i FSK-së, gjeneralallejtënant Rahman Rama qëndroi për vizitë zyrtare në SHBA



Komandanti i FSK-së gjeneralallejtënant Rahman Rama, i shoqëruar nga ambasadorja e Republikës së Kosovës Vlora Çitaku, atashu i Mbrojtjes në SHBA kolonel Ilir

Qeriqi, atashu i Mbrojtjes së SHBA-ve në Prishtinë koloneli Jeffrey H. Fisher si dhe nga komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralmajor Timothy Orr, më 17 maj 2018 mori pjesë

në ceremoninë e 25-vjetorit të Programit të Partneritetit Shtetëror (SPP) të Gardës Kombëtare të SHBA-ve, ku u prit nga gjeneral Joseph L. Lengyel, Komandant i Byrosë së Gardës Kombëtare në Kolegjin Kombëtar të Luftës, Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare Ft McNair, Washington DC. Gjeneral Rama e falënderoi Gjeneralin Lengyel për partneritetin e jashtëzakonshëm. Ai theksoi vizitën e fundit në Kosovë të mbi 100 qytetarëve të Ajovës nga sektorë të shumtë si: arsimi, bujqësia, biznesi i vogël, sporti, ushtria, siguria. Në veçanti e falënderoi për kontributin e zhvillimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 6".

Në kuadër të kësaj vizite, gjeneral Rama u takua me zyrtarët të lartë të Departamenti të Shtetit, Mr. Matt Palmer dhe me ndihmës asistenten e Sekretarit të Mbrojtjes Ms. Laura Copper me të cilët diskutoi mbi zhvillimet e fundit në FSK, sfidat e sigurisë në rajon dhe procesin e tranzicionit të FSK-së në FAK. Gjeneral Rama i njoftoi me të

arriturat e deritashme të FSK-së si një forcë e besueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe i falënderoi për mbështetjen e deritashme. Gjeneral Rama po ashtu pati takim në Senat, ku u takua me Senatorin Joni Ernst nga Ajova. Me këtë rast biseduan lidhur me zgjerimin dhe dinamizmin e Partneritetit Ndërshtetëror. Gjithashtu Gjeneral Rama u takua me kongresmenin Mike Turner nga Komiteti për NATO, me të cilin pati mundësi diskutimi lidhur me hapat dhe proceset e mundshme për integrim në strukturat e sigurisë rajonale dhe euroatlantike, si dhe e njoftoi për bashkëpunimin e FSK-së me NATO-n. Gjeneral Rama pati rastin dhe nderin të takonte të ftuarën e nderit për këtë mbrëmje, zonjën Dr. Heather Wilson, më ç' rast theksoi vlerën e partneritetit dhe aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të mbështetur në orientime perëndimore dhe euroatlantike që ka Kosova.

Gjeneral Rama me sekretaren e Forcave Ajrore biseduan edhe

mbi mundësinë për të përmirësuar sigurinë kibernetike në Kosovë, përmes mbështetjes së Forcave Ajrore, si zonë kryesore e misionit të Forcave Ajrore të SHBA-së. Në mënyrë të veçantë ai e falënderoi atë për mundësinë e përfshirjes së Kosovës për të konkurruar për herë të parë, për një vend (kadetë) në Akademinë e Forcave Ajrore të SHBA-ve në vitin 2019.

Gjeneral Rama pati mundësinë të vizitonte edhe Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare, ku për herë të parë, duke filluar nga gushti i këtij viti, një pjesëtar i FSK-së dhe një anëtar i PK-së, do të marrin pjesë në këtë universitet. Ky bashkëpunim do të mundësojë zhvillimin profesional të mekanizmave të sigurisë në vend. Po ashtu ai ka pasur edhe një vizitë të shkurtër në Akademinë e Trajnimit të Shërbimit të Emergjencave të Uashingtonit. Komandanti i FSK-së gjatë qëndrimit në SHBA u intervistua nga Zëri i Amerikës, mediat e Gardës Kombëtare dhe nga gazetarja e NBC.

Ministri Berisha priti ambasadorin e Francës Didier Chabert

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotëri Rrustem Berisha priti më 21.05.2018, priti në takim, një delegacion të lartë të shtetit francez në krye me ambasadorin zotëri Didier Chabert. Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi ambasadorin Chabert për mbështetjen dhe përkrahjen që shteti i Francës ka ofruar për Kosovën në shumë fusha si: politikë, siguri, etj., duke filluar që nga kontributi i Francës në kuadër të KFOR-it, kontributi në administratë e në fusha tjera. Ministri Berisha gjithashtu e njoftoi diplomatit francez mbi

zhvillimet në sektorin e sigurisë në Kosovë, integrimin e komunitetit joshumicë, si dhe për planet për të ardhmen. Ministri Berisha në veçanti çmoi lartë angazhimin e Francës në intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, me akreditimin për herë të parë të atashut të Mbrojtjes për Kosovë, si dhe angazhimin e vazhdueshëm për avancimin e marrëdhënieve në këtë fushë.

Nga ana e tij, ambasadori i Francës në Kosovë, zotëri Didier Chabert e përgëzoi ministrin për të arriturat dhe për kultivimin e një bashkëpunimi të vazh-



dueshëm ndërmjet dy vendeve. Ambasadori e njoftoi ministrin Berisha me emërimin e atashut të Mbrojtjes dhe akreditimin e tij për Kosovë, kolonel Fabrice

Duda, si dhe paralajmëroi intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Ambasadori Chabert gjithashtu paralajmëroi vizitën zyrtare në MFSK të Sek-

retares së shtetit pranë Ministrisë së Armatave në Qeverinë e Francës që do të zhvillohet së shpejti, vizitë kjo që pason vizitën e ministrit Berisha në Francë në vitin e kaluar. Ministri Berisha si dhe ambasadori Chabert shprehën gatishmërinë e dy vendeve tona për një bashkëpunim dhe intensifikim të tij në fushën e sigurisë në të ardhmen, që për Republikën e Kosovës është jashtëzakonisht me interes duke ditur rolin e Francës në Evropë si në Bashkim Evropian dhe në NATO.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama merr pjesë në Konferencën e Shefave të Mbrojtjes në Gjermani

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama mori pjesë në takim vjetor të shefave të mbrojtjes në Wiesbaden të Gjermanisë. Në këtë konferencë morën pjesë shefat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s dhe shteteve partnere. Konferenca vjetore e shefave të mbrojtjes, e cila u organizua nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropë, kishte për tematikë luftën kundër organizatave ekstremiste të dhunshme.

Në njërin prej seancave të konferencës ka folur edhe ko-



mandanti i FSK-së, gjeneral Rama i cili u fokusua në qasjen gjithëpërfshirëse të Kosovës në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, progresin e saj në parandalimin e këtij fenomeni si dhe vendosjen e një baze ligjore të aplikueshme që rregullon çështjen e pjesëmarrjes së shtetasve të Kosovës në luftërat e huaja.

Gjeneral Rama gjatë qëndrimit në Wiesbaden u takua edhe me gjeneralin Curtis M. Scaparrotti, të cilin e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme dhe përbajtësore të cilën Komanda

e Ushtrisë Amerikane për Evropë po e jep për mbështetjen për Republikën e Kosovës, rajonin e Ballkanit në përgjithësi e veçanërisht në ngritjen profesionale të FSK-së.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama në këtë konferencë pati mundësi të takonte shefa të mbrojtjes me ç' rast diskutuan mbi kompleksitetin dhe sfidat e sigurisë në regjion, si dhe shkëmbyen pikëpamje mbi kontributin dhe angazhimin e secilit për krijimin dhe ruajtjen e një ambienti të qetë dhe të sigurt.

Ministri dhe komandanti i FSK-së pritën komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralin Timothy Orr



Ministri i FSK-së zoti Rrustem Berisha, më 9.05.2018, priti komandantin e Gardës Kombëtare (GK) të Ajovës gjeneralmajorin Timothy Orr, të shoqëruar nga një delegacion i gjerë civil dhe ushtarak nga Ajova dhe nga koloneli Jeffrey Fisher, atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e SHBA-së në Prishtinë.

Ministri Berisha me këtë rast vlerësoi lart shkallën

e bashkëpunimit të gjerë dhe intensiv në kuadër të partneritetit ekzistues në mes MFSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, duke theksuar se sukseset e arritura të FSK-së janë edhe meritë e kësaj garde dhe personalisht të gjeneralit Orr. Ministri Berisha theksoi edhe faktin se FSK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besuar i sigurisë në vend dhe me një trend rritjeje edhe të qytetarët serbë. Po ashtu prezantoi

prezantuar rezultatet e FSK-së për integrimin e komuniteteve pakicë, në veçanti të komunitetit serb. Ai foli edhe për përfaqësimin gjinorë në FSK, duke nënvizuar se, që nga marsi i këtij viti, FSK-ja për herë të parë ka një femër me gradën e gjeneralit.

Në këtë takim, ministri vlerësoi lart pjesëmarrjen e pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës në ushtrimin fushor "Shqiponja -6", duke çmuar kontributin e tyre të vlefshëm si në fazën e përgatitjes së ushtrimit, po ashtu edhe në atë të ekzekutimit dhe sidomos shkallën e lartë të ndërveprueshmërisë së tyre me pjesëtarët e FSK-së.

Nga ana e tij, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr, është shprehur se në Kosovë ndihet si në shtëpinë e tij. Ai ka përgëzuar ministrin për rezultatet e deritashme,

sidomos ka vlerësuar lart integrimin e komunitetit serb në FSK, dhe rritjen e besueshmërisë në veri të vendit. Ai po ashtu ka falënderuar ministrin Berisha, për mundësinë e pjesëmarrjes në ushtrimin fushor "Shqiponja-6" të pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajovës, që përveç kontributit dhe rëndësisë së rritjes së ndjenjës së bashkëpunimit është edhe një përvojë e re për ata, koordinimi me partnerët në situata emergjente.

Komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Orr, zhvilloi një takim edhe me komandantin e FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramën, ku së bashku biseduan për zhvillimet në FSK-së, përgatitjen e planeve për transformim dhe sfidat aktuale që po has ky proces.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjeneral Rama e njoftoi gjeneralin Orr, për



rrjedhat e ushtrimit fushor "Shqiponja 6", duke theksuar se " ushtrimi po zhvillohet mirë dhe për FSK-në është sukses që për herë të parë kemi një numër kaq të madh të shteteve pjesëmarrëse". Temë bisede ishte edhe integrimi i suksesshëm i komuniteteve në FSK. "Tani kemi një tregim suksesit edhe me integrimin e komunitetit serb nga veriu i Kosovës, fakt ky që na bënë të ndihemi mirë".

Ai po ashtu e ka njoftuar gjeneralin Orr edhe me rezultate e konferencë "FSK dhe Partnerët" duke i thënë se ishte mjaft e suksesshme dhe me numër një numër të madh të shteteve pjesëmarrëse.

Gjenerali Orr, në fund të takimit u shpreh se " ju si ministri dhe FSK-ja, keni bërë gjërat e duhura dhe në kohën e duhur. Ky është shtegu i suksesit që FSK-ja duhet ta ndjekë edhe në të ardhmen".

Gjenerali Enver Cikaqi vizitoi ushtrimin fushor "Comabined Resolve X", në Gjermani

Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi, më 8 maj 2018, ka vizituar operacionin e ushtrimit "Comabined Resolve X", ku po marrin pjesë edhe 15 pjesëtarë të FSK-së, në Ditën e Vizitorëve të Shquar, krahas personaliteteve tjera ndërkombëtare, në Gjermani. Gjeneral Cikaqi, nga drejtuesit e ushtrimit, mori komente dhe vlerësime shumë të larta për angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin që po tregojnë pjesëtarët e FSK-së, të cilët gjatë zhvillimit të këtij ushtrimi kanë pasur mundësi të puno-

jnë dhe operojnë krah për krah me kolegët e tyre nga ushtritë ndërkombëtare, duke përfutur nga shkëmbimi i përvojave se si duhet punuar dhe vepruar në një mjedis shumëkombësh.

Gjatë kësaj vizite, komandanti i Forcave Tokësore, gjenerali Enver Cikaqi, pati takime të shumta me përfaqësues të ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s, me të cilët diskutoi për krijimin e mundësive rreth shkëmbimit të përvojave në kuadër të bashkëpunimit dypalësh rajonal.

Ushtrimi "Comabined Resolve X" po realizohet nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR)



në Bazën e Ushtrisë Amerikane në Grafenëhr të Gjermanisë. FSK-ja në këtë ushtrim po merr

pjesë me një kontingjent prej 15 pjesëtarësh. Fokusi dhe objektivi i këtij ushtrimi është ndërve-

primi operacional i të gjithë pjesëmarrësve nga ushtria e NATO-s dhe aleatë tjerë, për të kuptuar dhe krijuar procedurë operuese të përbashkëta. Ky është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore (Multi Unifeied Land Operation), i drejtuar nga Shtabi i Departamentit të Ushtrisë së SHBA-ve, për të stërvitur forcën e caktuar rajonale të SHBA-ve, të nivelit të brigadës, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të SHBA-ve (EUCOM), për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-s.

„Shqiponja 6”, test për kapacitetet reago



dhe të sigurisë. Situata e cila është dizajnuar është bërë në funksion të asaj që të gjitha agjencive pjesëmarrëse në këtë ushtrim t’iu mundësohet që t’i testojnë kapacitetet e veta reaguese në kuadër të misionit të vet kushtetues që e kanë në Kosovë dhe mbështetjes së partnerëve në mbështetje të trupave tanë në terren”, tha Haziri.

Haziri theksoi se shtetet pjesëmarrëse në këtë ushtrim do t’i testojnë standardet operative të përbashkëta. “Jemi pjesëmarrës tetë shtete në këtë ushtrim fushor që do t’i testojmë standardet operative të përbashkëta me partnerët dhe ndërveprueshmërinë tonë. Qëllimi kryesor i kësaj është që kurdoherë, në situata reale që paraqiten, ne të jemi të gatshëm të ndërveprojmë dhe të reagojmë në situata reale që ndodhin, duke i menaxhuar sa më mirë që është e mundur, në të mirën e qytetarëve, qoftë të Kosovës, qoftë të vendeve partnere”, shtoi Haziri.

Ushtrimi fushor “Shqiponja 6” e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka mbledhur tetë shtete të cilat do ta zhvillojnë këtë ushtrim për të testuar kapacitetet mbrojtëse në situata emergjente dhe komplekse të sigurisë. Ky ushtrim do të zhvillohet në gjashtë komuna të Kosovës, në Prishtinë, Obiliq, Mitrovicë, Podujevë, Gjilan dhe Novobërdë.

Drejtori i ushtrimit fushor “Shqiponja 6” gjeneral bri-

gade, Naim Haziri, tha se ky ushtrim ka qenë i planifikuar që nga shkurti i vitit 2017, dhe ka për qëllim testimin e kapaciteteve reaguese të pjesëmarrëseve në ushtrim.

“Qëllimi i këtij ushtrimi është që të realizohet një ushtrim fushor në nivel të FSK-së me pjesëmarrje të partnerëve, qofshin ata vendorë apo ndërkombëtarë, që të vlerësohen kapacitetet reaguese në situata komplekse, emergjente



Shpend Tërdeva nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës e quajti rast të mirë këtë ushtrim për

demonstrimin e aftësive. „Ky ushtrim është një rast i mirë për demonstrimin e aftësive

Ministri Berisha dhe komandanti Rama në vendkomandën e ushtrimit fushor „Shqiponja 6”



Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, vizituan vendkomandën e ushtrimit fushor ndërkombëtar, në fshatin Koliq të Prishtinës, ku janë të dislokuar pjesëtarët e FSK-së së bashku me pjesëtarët e ushtrive partnere për të realizuar ushtrimin fushor „Shqiponja 6”, të parin ushtrim me karakter ndërkombëtar. Në

Komandën e Përparme Operacionale, të vendosur në fshatin Koliq, ku ishin të përfaqësuar të gjitha njësitë e ushtrimit fushor ndërkombëtar „Shqiponja 6”, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj njoftoi për audiencën kryesore të ushtrimit si dhe njësitë pjesëmarrëse.

Gjatë vizitës, ministri Berisha dhe gjeneral Rama, u njoftuan nga drejtori i ushtrimit fushor, gjeneral brigade Naim Haziri, me qëllimin, objektivat, skenarin

e ushtrimit fushor dhe me aktivitetet që janë paraparë të zhvillohen së bashku me ushtritë e vendeve partnere, Policinë e Kosovës, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave si dhe Kryqin e Kuq të Kosovës. Ndërkaq, komandanti në detyrë i ushtrimit, nënkoloneli Sylejman Cakaj, para ministrit dhe komandantit të FSK-së, paraqiti një ekspozitë të aktiviteteve dhe operacioneve të zhvilluara që nga dita e dislokimit e deri më sot, si dhe i njoftoi ata, me bashkërendimin e veprimeve dhe ndërve-

prueshmërinë e FSK-së, me institucionet vendore dhe partnerët gjatë këtyre ditëve që po zhvillohet ushtrimi.

Me këtë rast, ministri i FSK-së, Rrustem Berisha përgëzoi stafin planifikues dhe menaxhues të ushtrimit duke shprehur besimin e plotë se skenari i ushtrimit do të realizohet në tërësi dhe se ushtrimi do t’i arrijë objektivat e veta trajnuese.

Nga ana a tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e vlerësoi si mjaft të rëndësishme pjesëmarr-

rjen e ushtrive partnere në ushtrim, atë të KFOR-it, si dhe agjencive vendore; duke theksuar se është me rëndësi komunikimi dhe ndërveprueshmëria ndërmjet institucioneve, në mënyrë që ushtrimi ndërkombëtar të arrijë objektivat e veta, ashtu siç është planifikuar.

Në Komandën e Përparme Operacionale, qëndruan sot edhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, të vendeve partnere, atashë të akredituar si dhe zyrtarë të lartë të Presidencës dhe agjencive të sigurisë. Për herë të parë pjesë e këtij ushtrimi, me njësitë dhe përfaqësuesit e tyre, janë edhe shtetet si: Shqipëria, Garda e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë (SHBA), Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, KFOR-i dhe përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë dhe Emergjencave të Kosovës; Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Kryqi i Kuq i Kosovës. Ushtrimi fushor i FSK-së “Shqiponja 6” përveç ushtrimeve të parapara në territorin e fshatit Koliq, është duke i vazhduar aktivitetet edhe në territorin e komunës së Prishtinës, Obiliqit, Podujevës, Novobërdës dhe Gjilanit. Ushtrimi fushor „Shqiponja 6” ka filluar zbatimin e skenarit-praktik në terren, më 4 maj dhe do ta përmbyll ushtrimin më 11 maj 2018.

guese të FSK-së në situata komplekse



zat e sigurisë rajonale dhe përfundimisht do të jetë një rast i jashtëzakonshëm për ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta në raste të nevojave operacionale", - theksoi Tërdeva.

Pjesë e ushtrimit fushor "Shqiponja 6" do të jetë edhe ushtria amerikane. Kolonel Justin Wagner tha se ky është një vit i veçantë dhe historik për këtë ushtrim, pasi që është hera e parë që Forca e Sigurisë së Kosovës ka organizuar një ushtrim të kësaj madhësie me skuadrat e specialiteteve ushtarake nga tetë vende të ndryshme. "Si partnerë ndërkombëtarë, ne jemi të nderuar që luajmë një rol, ndihmojmë dhe zhvillojmë, ekzekutojmë dhe vlerësojmë stërvitjen e këtij viti. Pjesëmarrja në këtë stërvitje është një mundësi e jashtëzakonshme për ne si partnerë ndërkombëtarë për të trajnuar forcat tona dhe për të kombinuar mjedisin, diçka që ne nuk kemi gjithmonë mundësi për të bërë, sidomos me fokusin në përgjigjen ndaj katastrofave



Ky ushtrim është në kohë të duhur dhe i përshtatet mirë aftësisë aktuale të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo u lejon atyre (FSK-së) të demonstrojnë aftësinë për t'i ardhur në ndihmë të gjithë popullit të Kosovës në kohë katastrofash natyrore ose atyre të shkaktuara nga njeriu", - tha Wagner.

Koloneli Wagner u shpreh i impresionuar me planifikim-

in dhe vëmendjen ndaj detajeve, të cilat anëtarët e FSK-së i kanë afruar këtij ushtrimi. Sipas tij, ky është një testim për fokusin që ata kanë vënë në ndërtimin e kapaciteteve në mandatin e tyre aktual dhe zhvillimin e aftësisë së lartë për KFOR-in dhe partnerët rajonalë. Ushtrimi fushor "Shqiponja 6" do të zgjasë nga sot deri më 11 maj 2018.

profesionale në nivel vendi dhe atij ndërkombëtarë për të gjithë pjesëmarrësit. Po ashtu

është një rast i mirë ku forcat e sigurisë pjesëmarrëse të njihen mes veti, të zhvillohen mbi ba-

Komandanti i FSK-së ndanë certifikata mirënjohje për pjesëmarrësit e ushtrimit fushor „Shqiponja 6”



Në MFSK, më 12 maj 2018, me aktorët pjesëmarrës, u mbajt takimi vlerësues për zhvillimet e ushtrimit fushor "Shqiponja-6". Në takim ishin të pranishëm komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, komandanti i KFT-së, gjeneral major Enver Cikaqi, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Naim Haziri, oficerë dhe nënoficerë nga ushtritë e shteteve pjesëmarrëse, FSK-ja dhe agjencitë emergjente. Takimin e

kryesoi drejtori i ushtrimit, gjeneral brigade Naim Haziri, i cili konstatoi se, ushtrimi fushor ka qenë shumë i suksesshëm, i ka arritur objektivat e planifikuar dhe është zhvilluar i tëri sipas planit dhe pa ndonjë lëndim apo incident të pjesëmarrëseve.

Komandanti i FSK-së gjeneralletenant Rrahman Rama, në fjalën e tij me rastin e përfundimit të ushtrimit fushor "Shqiponja-6", vlerësoi lart pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shteteve pjesëmarrëse,

duke falënderuar dhe duke ju shprehur mirënjohje për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre profesional. "Niveli i arritur në këtë ushtrim ishte një shkallë e re e organizimit dhe përvijë e re për ne, rezultati i së cilës na inkurajon që në të ardhmen të kemi edhe më shumë shtete pjesëmarrëse. Në këtë mënyrë ne rrisim bashkëpunimin dhe njohjet si dhe besimin mes pjesëtarëve të ushtrive mike dhe aleate. Na gëzon fakti që kemi arritur këtë sukses,

por kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për më mirë. Ky ushtrim e ka arritur qëllimin e paracaktuar, ka qenë ushtrim i madh dhe i rëndësishëm për FSK-në dhe Kosovën. Ka qenë ushtrim historik. Është e rëndësishme të jemi të ndërveprueshëm me institucionet vendore, por kur jemi të ndërveprueshëm me partnerët ndërkombëtarë, atëherë kjo tregon se FSK-ja është e gatshme për detyra të reja dhe misione ndërkombëtare. Urojmë

që të ju kemi serish në Kosovë, edhe në ushtrimet tjera. Do të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen, sepse ne dëshirojmë të jemi pjesë e juaja, të jemi anëtarë në NATO-s". Me pastaj, komandanti i FSK-së, ndau certifikata mirënjohjeje për përfaqësuesit e njëjsteve të shteteve pjesëmarrëse dhe për individët e dalluar të cilët kontribuan në mbarëvajtjen e ushtrimit fushor "Shqiponja-6".

Ministri Berisha në manifestimin për “Ditën e Çlirimit” në Shqiponjë të Dushkajës

Në manifestimin për nder të 17 Majit “Ditën e Çlirimit” dhe “Ditën e Dëshmorëve” të Shqiponjës së Dushkajës të Komunës së Gjakovës, në emër të Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha bëri homazhe para obeliskut të dëshmorëve si dhe mbajti një fjalë rasti në emër të parit të Qeverisë. Me këtë rast, ministri Rrustem Berisha çmoi lartë rolin e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave të Shqiponjës së Dushkajës, të Komunës së Gjakovës, për kontributin në filet e organizimit të luftës së UÇK-së, konsolidimit e deri në përfundim të luftës, çlirimit e rajonit të Dushkajës dhe të vetë Shqiponjës, vendlindjes së shumë heronjve të UÇK-së, si dhe bazë e sigurt e strehimit dhe rrugë e furnizimit për shumë zona të luftës.



Në vazhdim, ministri Berisha, tha: “Jam shumë i nderuar, që sot në Shqiponjë, si ministër i FSK-së mund të ju drejtohem, në këtë ditë të shënuar, jo vetëm për shqiponjën, por edhe për trevën e Dushkajës, Gjakovës dhe tërë

Kosovës. Këtë nderim e shpreh edhe në emër të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj”. “Sa herë përmendet Shqiponja, në mbamëndjen tonë dhe të historisë, na vije kujtesa për pushkët e para të lir-

isë, pastaj shndërrimin e këtij territori në zonë të pakalueshme për forcat serbe në atë kohë, pikërisht nga dëshmorët e lirisë dhe heronjtë e Kosovës që i nderojmë sot, po edhe shumë luftëtarë të gjallë të këtyre trevave që malet

e Dushkajës dhe Sukën e Cermjanit e bënë fortifikatë pararojë të Jabllanicës së atëherëshme ndaj forcave të shumta serbe të asaj kohe...”. Më tej, ministri Berisha, në manifestimin e 17 Majit “Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të fshatit Shqiponjë” bëri një ndërlidhje të sakrificës së popullit tonë në luftën për çlirim si dhe aktualitetit, ku populli i Kosovës dhe shteti ynë është duke ndërtuar institucione të qëndrueshme të cilat garantojnë paqe dhe prosperitet për shtetin tonë dhe gjithë qytetarët e saj. Në Shqiponjë ishte i pranishëm edhe kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës Kadri Veseli, kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, deputeti Daut Haradinaj, gjeneralët e FSK-së: Xhevahir Geci dhe Fadil Hadergjonaj, si dhe përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të vendit si dhe qytetarë të shumtë.

Kadetët e Kosovës në shënimin e Ditës së Personelit Ushtarak të Forcave të Armatosura të Turqisë

Në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë në Ankara, më 8.05.2018, është shënuar Dita e Personelit Ushtarak Mysafir (MAP Günü). Në mesin e kadetëve nga 20 shtete të ndryshme të botës, Republikën e Kosovës e prezantuan 9 kadetë të Kosovës, që studiojnë në Akademinë Ushtarake në Turqi. Të pranishëm ishin edhe kadetët që janë duke vijuar mësimet në Fakultetin e Mjekësisë Ushtarake (GATA). Me rastin e shënimit të kësaj dite, aktivitetet e kadetëve të FSK-së, u zhvilluan nën organizimin dhe përkujdesjen e atashut ushtarak të FSK-së, në Ankara, nënkolonelit Bekim Os-

mani. Kadetët tanë, atje, prezantuan me dinjitet shtetin e Kosovës, FSK-në, kulturën dhe traditën e vendit tonë. Në këtë ditë, i gjithë personeli i huaj kishte për detyrë që të përfaqësojë vendin e vet me ushqime, veshje kombëtare, uniformën ushtarake, fotografi me bukuritë natyrore, broshura të ndryshme rreth organizimit dhe aktiviteteve ushtarake, etj. Përveç komandantit të Akademisë i cili njëherësh ishte edhe nikoqir, për ta përcjellë këtë ngjarje kishin ardhur edhe shumë gjeneralë dhe oficerë tjerë të lartë vendorë si dhe atashë nga vende të ndryshme të botës. Gjatë vizitës së tyre tek këndi i Kosovës, nga atashë ynë, ata u njoftuan me atë që kishin



përgatitur për përfaqësim duke jua përshkruar në pika të shkurt-

ra historinë dhe bukuritë natyrore të Kosovës. Kadetët tanë, në mënyrë të shkëlqyer kishin përgatitur këndin e përfaqësimit dhe këndin e ushqimeve, të cilat nuk kaluan pa fjalë miradije nga komandanti i Akademisë Ushtarake dhe të gjithë të pranishmit tjerë. Sidomos u krijua një atmosferë mjaft e mirë gjatë ekzekutimit të valles shqiptare nga kadetët tanë dhe ata të Shqipërisë, e cila bëri që të ndizet atmosfera, duke u bërë kështu pjesë e saj pothuajse edhe të gjithë kadetët e vendeve të tjera. Edhe këtë vit, kjo paraqitje u realizua me përkrahjen e FSK-së, Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara, dhe familjeve të stafit të ambasadës.

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral Spahiu priti komandantin e KFOR-it, gjeneralin Salvatore Cuoci



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneral brigade Irfete Spahiu, priti në vizitë komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Salvatore Cuoci. Gjatë kësaj vizite, për komandantin e KFOR-it, u prezantua struktura, misioni i KDS-së dhe planet për të ardhmen. Gjithashtu, komandanti i KFOR-it, pati rastin të vizitojë dhe të shohë nga afër disa nga mjediset ku zhvillohen trajnimet në Ko-

mandën e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe po ashtu të njihet me trajnimet të cilat ofrohen në këtë qendër për pjesëtarët e FSK-së.

Gjatë takimit të përbashkët, gjeneral Cuoci e përgëzoi komandantin e KDS-së, gjeneral Spahiu, për ngritjen e saj në detyrë, si dhe shprehu gatishmërinë e tij, për mbështetjen e vazhdueshme të FSK-së dhe në veçanti të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj priti drejtorin e NALT-it, gjeneralin Ralf Hoffmann

Në ambientet e kazermës "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK-së, në Istog, komandanti i saj, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj me bashkëpunëtorë, priti më 18 maj 2018, në një takim zyrtar, drejtorin e NALT-it, Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillues të NATO-s për FSK-në, gjeneral brigade Ralf Hoffmann. Komandanti i BRSH-së, gjeneral Hadërgjonaj, me këtë rast e njoftoi drejtorin e NALT-it me zhvillimet e përgjithshme në BRSH dhe njësitë e saj, si dhe me strukturën, misionin, detyrat, aktivitetet dhe të arriturat e



BRSH-së, me fokus në arsimimin dhe stërvitjen e personelit, infra-

strukturën dhe pajisjet. Në ambientet e kazermës "Ushtarët e NATO-s", ata vizituan disa nga objektet e brigadës si: poligonet, pajisjet, armatimin, automjetet dhe u informuan për aktivitetet e Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Batalionit të Dytë. Gjenerali Hoffmann shprehu respektin dhe përshtypjet e tij shumë pozitive kundrejt BRSH-së, në përgjithësi dhe për ushtrimin fushor "SHQIPONJA 6" në veçanti, duke theksuar se kishte vizituar dhe ndjekur nga afër organizimin dhe operimin e Forcës në Detyrë në Bazën e Përparme Operacionale, si dhe përmes vëzhguesve

dhe kontrolluesve të NALT-it në nivele të ndryshme. Po ashtu, ai vlerësoi lart standardet e instaluar në BRSH dhe nivelin e lartë të zbatimit të tyre si në aspektin e disiplinës, mirëmbajtjes së pajisjeve dhe automjeteve, ashtu edhe infrastrukturës akomoduese dhe asaj përcjellëse. Në fund të vizitës drejtori i NALT-it, gjenerali Hoffmann, uroi gjeneralin Fadil Hadërgjonaj dhe stafin e tij për punën dhe profesionalizmin duke ofruar mbështetjen e tij, si dhe siguroi që të ofrojë ekspertizë përmes këshilltarëve të NALT-it, në të gjitha nivelet ku kërkohet.

Përurohët rruga në Budisalc të Klinës

Forca e Sigurisë së Kosovës në vazhdimësi është duke ndihmuar popullatën e Kosovës me projekte, që po i realizojnë bashkëpunim me organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Sot, është bërë përurimi rrugës në fshatin Budisalc i banuar kryesisht me popullatë të komunitetit serbë, ndërsa punët janë kryer nga Batalioni i Xhenios i Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me komunën e Klinës, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, organizatën IOM dhe mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar. Realizimi i projekteve të tilla ka për qëllim lehtësimin e jetës dhe qarkullimin më të lehtë të qytetarëve të Kosovës, ndërsa realizimi i këtij projekti, do t'ju lehtësojë banorëve të fshatit qarkullimin dhe qasjen më të mirë në Manastirin e Budisalcit. Në përuimin e rrugës morën pjesë: komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Ruairi O'Conell, kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, drejtori i Drejtorisë për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak në MFSK, Hajrush

Kurtaj, përfaqësues të IOM-it, Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, përfaqësues të manastirit të fshatit Budisalc, banorë të fshatit, oficerë të KFOR-it dhe të FSK-së. Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj falënderoi ambasadorin e Britanisë, komandantin e FSK-së dhe FSK-në për angazhimin dhe kontributin e dhënë për mbështetjen në kryerjen e punimeve në këtë rrugë. Ndërsa, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Conell falënderoi FSK-në, për angazhimin dhe kryerjen e shërbimeve për të gjitha komunitetet. Ai tha se: „me FSK-në, kemi bashkëpunuar ngushtë në realizimin e këtij projekti“. Kurse, komandanti i FSK-së, gjeneralallejtënant Rrahman Rama, me këtë rast theksoi se, „ne si FSK, për çdo ditë po e dëshmojmë se jemi forcë e besueshme për të gjithë qytetarët me punën dhe angazhimin tonë. Sa do, që është një projekt simbolik, ne po mundohemi të krijojmë kushte sa më të mira për lëvizjen e gjithë qytetarëve pa dallime etnie. Ne do të vazhdojmë të mbështesim dhe të japim kontributin tonë edhe në të ardhmen në të gjitha fushat me kapacitetet tona“.

Komandanti i RMC-së, koloneli Shaip Haziri priti drejtorin e NALT-it gjeneralin Ralf Hoffmann

Drejtori i NALT-it, Ekipit Këshillues Ndërlidhës i NATO-s, për MFSK/FSK-në, gjeneral brigade Ralf Hoffmann është pritur nga komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), koloneli Shaip Haziri dhe stafi i Regjimentit. Vizita e gjeneralit Hoffmann në RMC ishte e fokusuar në aspektin e ndihmës profesionale dhe këshillimit që po japin këshilltarët e NALT-it për FSK-në. Ai u njoftua nga komandanti i RMC-së, koloneli Haziri, për misionin e Regjimentit dhe njësitë nën varësi për punën dhe aktivitetet të cilat zhvillohen në kuadër të Regjimentit të Mbro-

jtjes Civile. Gjenerali Hoffmann rëndësi të veçantë i ka dhënë edhe vizitës në Qendrën Trajnuese për Kërkim-Shpëtim, ku është takuar me stafin dhe instruktorët e kësaj qendre duke u njoftuar për misionin, aktivitetet e kaluara, ato në realizim e sipër dhe objektivin apo synimin për të ardhmen. Gjenerali Hoffman u nda i kënaqur me punën dhe i përgëzoi të gjithë për angazhimin dhe theksoi se do të jetë në mbështetje të Regjimentit në ngritjen e kapaciteteve të tij, si dhe në mbështetje në trajnime e këshillime nga ekspertët e kësaj fushe.

Në Universitetin Amerikan diplomojnë 15 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së

Dje, (17.05.2018) në AUK u mbajt ceremonia e diplomimit të studentëve të këtij universiteti. Në ceremoninë e diplomimit mori pjesë edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, gjenerali amerikan Wesley Clark, kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu, si dhe shumë mysafirë të ftuar.

Në këtë ceremoni, diplomuan edhe 15 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast, gjenerali amerikan në pension Wesley Clark, mbajti një ligjëratë për kadetët dhe stafin udhëheqës të Qendrës për Studime Universitare (QSU). Në këtë ligjëratë ishin të pranishëm: Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Irfete Spahiu dhe stafi i AUK-ut. Ushtruesi i detyrës së Komandantit të Qendrës për Studime Universitare, kapiteni Vegim Krelani mirëpriti dhe falënderoi gjeneralin Clark, për gatishmërinë e treguar për të ligjëruar para stafit dhe kadetëve të QSU-së.

Gjenerali amerikan Wesley Clark, me të marrë fjalën, deklaroi se është i impresionuar me të arrit-



urat e FSK-së. Në ligjërimin e tij ai shpalosi përvojat dhe sfidat në karrierën e tij ushtarake. Rëndësi të veçantë i kushtoi përgatitjes profesionale dhe vendimmarrjes në të gjitha nivelet e udhëheqjes. Ai, më tutje elaboroi kornizën e udhëheqjes ushtarake përmes përshkrimit tëtributeve se si një lider duhet të: „JETË, DIJË DHE BËJË“, duke u bazuar në përvojat e tij personale si ushtarak. Ligjëratë u mirëpriti dhe u cilësua si mjaft produktive dhe e rëndësishme nga audienca, posaçërisht nga kadetët tanë të cilët patën mundësinë që t'i parashtrojnë edhe pyetje të shumta. Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, në përfundim të lig-

jëratës, gjeneralit Wesley Clark i dha dhuratë simbolike, në shenjë mirënjohje dhe respekti për kontributin e tij të dhënë për çlirimin e Kosovës.

Në ceremoninë e 14-të të diplomimit të kadetëve të FSK-së, në Universitetin Amerikan në Kosovë, diplomuan 15 kadetë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së prej të cilëve 13 kadetë i takonin vitit të IV-të "Gjenerata 2018", ndërsa 2 kadetë të vitit III-të, "Gjenerata 2019" të cilën arritën që me sukses t'i përfundojnë provimet- një vit më herët. Kadeti Premtim Shaqiri "Gjenerata 2018" u dekorua me çmimin "Highest Honours" për arritje të larta akademike.



KEK-u i dhuron tri automjete të shkatërruara Qendrës së Trajnimit për Kërkim - Shpëtim

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) i dhuroi tri (3) automjete të shkatërruara Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së në Pomozotin. Ky donacion është ndihmuar nga Dr.sc. Adil Januzi, drejtor Ekzekutiv i Divizionit të Prodhimit të Qymyrit në KEK. Drejtori i QTKSH-së lidhur me këtë donacion është shprehur: "Unë nuk mund ta theksoj mjaftueshëm vlerën e këtij donacioni.

Ekipi im i trajnimit dhe unë, jemi gjithëherë të angazhuar në kërkim të metodave të reja dhe kreative, për të ofruar përvoja



sa më të mira për studentët tanë. Për disa njerëz, këto automjete

mund të konsiderohen si mbeturina, por për ne këto automjete edhe pse të shkatërruara janë mjaft të rëndësishme, sepse na hapin mundësinë për të zhvilluar skenarë dhe përvoja të reja për studentët tanë, të cilët janë duke u trajnuar në kërkim-shpëtim urban, malor dhe ujëra.

Në këto skenarë përfshihen edhe katastrofat natyrore si: tërmetet, shembjet e dheut, vërshimet si dhe shkatërrimet nga vet njerëzit, siç janë: demolimi i ndërtesave, aksidentet industriale dhe shumë incidente të tjera. KEK-u gjithëherë ka qenë mbështetje e fortë e FSK-së edhe para se të hapej

QTKSH. Konkretisht, në shtator të vitit 2016, KEK-u na ka ofruar ndihmë inxhinierike dhe ekspertizë për lëvizjen e tre vagonëve të trenit, të dhuruar nga Trainkos, nga Fushë Kosova për në Pomozotin.

Kjo detyrë përfshinte një ekip të punonjësve të KEK-ut, të cilët kishin punuar gjatë tërë vikendit deri në mbrëmjet e vona". Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, çdo ditë e më tepër po zhvillohet dhe ngritet duke u bërë kështu pikë kyçe e ushtrimeve, jo vetëm për FSK-në por edhe për organizata tjera partnere siç është KFOR-i.

Në Brigadën për Reagim të Shpejtë u mbajt gara „Ujku Garues-2018”



Në kazermën "Ushtarët e NATO-s" të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, më 25.05.2018, u mbajt ceremonia e shpalljes së rezultateve të garës "Ujku Garues 2018".

Ky është viti i katërt më radhë, që BRSH-ja organizon këtë garë, në të cilën, pjesëmarrësit marrin pjesë si ekip dhe garojnë si një trupë e përbashkët. Këtë vit, kanë marrë pjesë gjithsej 13 ekipe, me nga pesë pjesëtarë nga Batalioni i Parë, i Dytë dhe i Tretë i BRSH-së, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QSU, KFOR-i Amerikan, Danez dhe Polak.

Në ceremoninë e certifikimit morën pjesë edhe komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, komandanti i KDS-së gjeneral brigade Irfete Spahiu, shefi i Shtabit të BRSH-së nënkolonel Ejup Maqedonci, komandantë të batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së dhe të njëjve

tjera të FSK-së.

Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi, falënderoi pjesëmarrësit në emër të komandantit të FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Ramës dhe përgëzoi Brigadën e Reagimit të Shpejtë për organizimin e shkëlqyer, si dhe ekipet e ushtrisë amerikane, daneze dhe polake.

Ndër të tjera, gjeneral Cikaqi, tha, se gara: "Ujku Garues-2018" është aktivitet i cili tregon ndërveprueshmërinë dhe aftësinë operuese të ekipeve pjesëmarrëse, por njëkohësisht me pjesëmarrjen e ekipeve të KFOR-it, pasqyrohet ndërveprueshmëria institucionale e FSK-së me aktorët tjerë të sigurisë në Kosovë, në këtë rast me KFOR-in.

"Unë si komandant i Forcave Tokësore dhe zv. komandant i FSK-së, jam tepër krenar që pjesëtarët tanë çdo ditë janë krah për krah me partnerët tanë në trajnime dhe në gara të ndryshme. Uroj që së shpejti të marrin pjesë edhe në misione të ndryshme.

Pjesëtarët tanë gjatë garave të ndryshme kanë arritur rezultate të shkëlqyeshme dhe shumë suksese në trajnime të ndryshme. Po dëshmojmë se ne jemi të gatshëm, për të marr detyra të reja në mbrojtje të vendit dhe të sigurisë", - tha në fund komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral Cikaqi.

Ndërsa, komandanti i BRSH-së, gjenerali Fadil Hadërgjonaj tha se "Qëllimi i mbajtjes së garave është që të testohen shkathtësitë ushtarake në disa disiplina, ta ngremë nivelin e aftësive psikofizike dhe profesionale të ekipeve tona, me theks të veçantë ta ngremë nivelin e punës ekipore dhe ta avancojmë shpirtin garues me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe ndërkombëtare. Rezultatet që janë arritur ndër vite tregojnë se pjesëtarët tanë gjithmonë kanë shfaqur aftësi të larta fizike dhe profesionale. Dua të theksoj vetëm disa nga garat e këtij viti, të karakterit gjithëpërfshirës dhe ndërkombëtar, siç ishte gara e ushtarit më të mirë në nivel të FSK-së, me pjesëmarrje ndërkom-




bëtare, pastaj gara e ushtarit më të mirë në Kroaci dhe së fundmi kjo garë ekipore që u përmbyll sot. Rezultatet e arritura tregojnë

për nivelin e lartë të përgatitjes fizike dhe profesionale të ushtarëve tonë në përgjithësi dhe në veçanti të pjesëtarëve të BRSH-së", tha gjeneral Hadërgjonaj.

Gjeneral Hadërgjonaj përgëzoi edhe ekipin e NOF të BRSH-së, instruktorët dhe ekipet vlerësuese për organizimin dhe realizimin e suksesshëm të garës, kurse ekipet garuese dhe ato të KFOR-it i falënderoi për pjesëmarrjen dhe i uroi për rezultatet e treguara. Në fund të garës, në bazë të paraqitjes së treguar në të gjitha disiplinat e kësaj gare u përzgjedhën tri ekipet më të mira. Vending e parë e zuri ekipi i dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë, vendin e dytë ekipi i parë i Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe vendin e tretë ekipi i KFOR-it polak.

Për të gjitha ekipet pjesëmarrëse në garë, KOMBRSH ndau certifikata dhe mirënjohje.





PROGNOZA SPORTIVE

SWEDEN - SOUTH KOREA

1

BELGIUM - PANAMA

1

TUNISIA - ENGLAND

1

FFK-ja bëhet me logo të re dhe fanella të reja

Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) është bërë me logo të re dhe sponsor të ri teknik për veshmbathje. Zëvendës-presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka bërë me dije se sponsori i ri teknik ishte meritë dhe punë e Fadil Vokrrit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 17 QERSHOR - Me një minutë heshtje në nderim të presidentit tashmë të ndjerë të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokri, ka nisur ceremonia e promovimit të logos së re të FFK-së si dhe sponsorit të ri teknik për veshmbathje "14 Fourteen" nga Zvicra. Para të pranishmëve, Diturie Hoxha, udhëheqëse e marketingut dhe komunikimit me publikun, ka prezantuar logon re që tash e tutje do të jetë në përdorim nga

FFK-ja.

Duke përshëndetur familjen e ish-presidentit Fadil Vokri, drejtorin ekzekutiv të kompanisë "14 Fourteen", Andrea Picciau dhe të pranishmit e shumë, zëvendës-presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se është një obligim i dyfishtë i FFK-së që ta ndjekë rrugën dhe vizionin e ish-presidentit Vokri. "Ne jemi zotuar ta çojmë vizionin e tij përpara", ka thënë ai. Ademi ka thënë se sponsori i ri teknik ishte meritë dhe punë e Vokrrit. "Ndaj ne sot vetëm po e vëmë në zbatim", është shpre-



hur zëvendës-presidenti i FFK-së, Agim Ademi.

Ndërkaq drejtori ekzekutiv i kompanisë "14 Fourteen", Andrea Picciau, ka thënë se po aq sa ndihet i nderuar që gjendet në Kosovë, aq ndihet i pikëlluar për mungesën e Vokrrit. "Dua t'ju shpreh ngushëllimet e mia familjes së z. Vokrrit, bashkëpunëtorëve dhe mbarë shqiptarëve. Jam i nderuar që pata rastin ta takoj dhe ta nis bashkëpunimin me një njeri kaq të veçantë siç ishte Vokri. Sikur që ju jeni një shtet i ri, edhe ne jemi një kompani e re dhe besoj se së bashku mund të bëjmë gjëra të mira", ka thënë Picciau, i cili ka shpjeguar në hollësi para të pranishmëve dizajnin e fanellave të reja që tash e tutje do t'i bartin të gjitha ekipet kombëtare në të dyja konkurrencat.

Sërish fjalën e ka marrë zëvendës-presidenti i FFK-së, Adem Ademi, duke theksuar se

kohët e fundit fokusi i ish-presidentit Vokri ka qenë tek ekipet kombëtare. "Ai u është gëzuar shumë sukseseve të fundit të Kombëtares A, prandaj besoj se të gjithë ne, veçmas futbollistët, të kenë një obligim të shtuar që t'i bartin me krenari fanellat dhe të shënojnë rezultate të mira, pasi vetëm kështu mund t'ia kthejmë borxhin ish-presidentit Vokri", ka deklaruar Ademi.

Fanella e parë me numrin 9 iu dorëzua djalit të ish-presidentit të FFK-së, Gramoz Vokrrit, kurse zëvendës-presidenti Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu ua dorëzuan nga një fanellë futbollistëve të Kombëtares "A" Edon Zhegrovës dhe Herolind Shalës, si dhe futbollistëve të Kombëtares "A" të femrave, Edona Kryeziu, Florentinë Kolgecit e Kaltrinë Biçkajt, edhe dy fanella të tjera, një për Getta Beçajn, tjetër për popstarin Trim Ademi (Capital T).



Biografia e krijuesit të logos së re të FFK-së

Piktori Sali Musliu, lindur në Gjilan në vitin 1966, ka dizajnuar logon fituese të FFK-së. Ai në vitin 2001 ka diplomuar në Akademinë e Artit në Dusseldorf, në klasën e artistit me reputacion botëror, prof. Konrad Klapheck. Ai është aktiv në skenën e artit dhe profesionalisht merret me pikturë në Frankfurt, ku vepron dhe jeton aktualisht. Gjatë vitit 2010 ka qenë profesor i artit në Kolejin AAB në Prishtinë, derisa më herët ka menaxhuar galerinë-atelienë e hapur në Prishtinë. Musliu ka fituar shumë çmime vendore dhe ndërkombëtare, derisa në vitin 1999 nga Akademia e Arteve në Dusseldorf e mori titullin "Mjeshtër i Artit". Veprat e piktorit Sali Musliu gjenden të ekspozuara në institucione të ndryshme, muze të artit dhe shumë koleksione private në të gjithë botën.



Ekipet që kanë shënuar më së shumti në kampionat botëror



PRISHTINË, 17 QERSHOR - Botërori i Rusisë ka filluar, por a keni menduar se kush është ekipi që ka luajtur më shumë në Botëror? Brazili dhe Gjermania kanë zhvilluar më shumë ndeshje në Botëroret e luajtur, respektivisht nga 104 dhe 106

ndeshje, gjithashtu janë klubet me më shumë gola të shënuara.

Lista e dhjetë ekipeve me më shumë gola të shënuar:

- 1) Gjermania 224
- 2) Brazili 221
- 3) Argjentina 132

4) Italia 128

5) Franca 108

6) Spanja 95

7) Hungaria 87

8) Holanda 86

9) Uruguai 81

10) Anglia 79

Më 6 korrik zgjedhet kryetari i FFK-së

PRISHTINË, 17 QERSHOR (ER) - Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka marrë vendim që Kuvendi i Jashtëzakonshëm zgjedhor për pozitën e kryetarit të FFK-së të

mbahet më 6 korrik. Për organizimin e këtij kuvendi është obliguar sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu. "Komiteti Ekzekutiv (KE), duke shqyrtuar gjendjen e jashtëzakonshme në futbollin e

Kosovës pas vdekjes së kryetarit legjendar, Fadil Vokri dhe pas mbështetjes dhe sugjerimeve të zyrtarëve më të lartë të FIFA-s dhe UEFA-s, për të mos lënë zbrazësi institucionale, mori këtë

vendim në bazë të kompetencave të veta të dala nga statuti i FFK-së", është thënë në arsyetimin për mbajtjen e Kuvendit të Jashtëzakonshëm zgjedhor të FFK-së.





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijes

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Datë: 18.06.2018
Nr. 1749/18

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve dhe raportit mësimdhënës nxënës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019 PRIZREN 18 QERSHOR 2018

1. SHKOLLA EKONOMIKE “YMER PRIZRENI” NË PRIZREN

Kontabilitet	2 X 24 nxënës = 48 nxënës
Banka e sigurime.....	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Asistent financiar.....	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Asistent marketingu	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Shpediter dhe logjistikë	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Tregti me shumicë dhe pakicë	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Teknologji ushqimore.....	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Asistent hotelieri	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Asistent juridik	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Asistent i administratës	1 X 24 nxënës = 24 nxënës
Agrobiznes	1 X 24 nxënës = 24 nxënës

Paralelja e ndarë në Gjonaj:

Kontabilitet

Paralelja e ndarë në Romaj:

Kontabilitet

2. GJIMNAZI “GJON BUZUKU” – PRIZREN

Gjimnazi në qendër në gjuhën shqipe:

Shkencat natyrore

Paralelja e ndarë në Gjonaj:

Shkencat natyrore

Paralelja e ndarë në Romajë:

